

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7490 E premte 6 Prill 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje
në "Deutsche Welle"
Partitë e një prej vendeve më të varfra të Europës paguanjnë shuma të majme për lobing. Transparenca e financimit të tyre mund të quhet dështimi më ...
Vijon në faqen 20

Nga LINDITA ARAPI
Financimi partiak në Shqipëri - xhungla gati e padepërtueshme


Opinion
i **Ditës**
Falangat e Edi Ramës janë hedhur në një kryqëzatë të dirigjuar për të denoncuar dhunën që disa segmente ende të vogla të shoqërisë po ushtrojnë ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI
Pse dhuna është e vetmja rrugë



Dokumenti, "Judicial Watch" akuzon diplomatën **Donald Lu: Akuzat për lidhjen me Sorosin? Pa lidhje, s'kemi dhënë para**
Ambasadori i SHBA: Klement Balili në Shqipëri, mund të arrestohet në ditët në vijim

Judicial Watch", një grupim aktivistësh amerikanë konservatorë kanë publikuar së fundmi dosjen se si miliarderi George Soros përfitoi nga paratë e taksapaguesve amerikanë për qëllimet e tij politike në Shqipëri. Ky grupim ka hetuar disa nga financimet e Soros në vende të ndryshme të lindjes dhe së fundmi ka publikuar ...
Në faqet 2-3

KRYEMINISTRI U KERKON NDJESE KUKSIANEVE: DUHET TA KISHIM SQARUAR ME PARE RRUGA E KOMBIT, RAMA: S'KA PAGESE PA GJETUR ZGJIDHJE

Opozita mbledhet pas bllokimit të rrugëve, Basha: Rama i pabesueshëm, heqje dhe jo pezullim të taksës. Plas sherri dhe mes pozitës për tarifën



(Në foto) Kryeministri Rama, duke folur dje në seancën parlamentare. Kryetari i PD Basha gjatë protestës së opozitës



NGA FERDINAND SAMARXHI
Kryepeshkopi Anastas Ngjallje e besimit të ortodoksë... dhe shqiptarëve
Në faqet 18-19

TIRANE E SHKODER
ALUIZNI: Lista me përfituesit që do të marrin tapitë e që duhet të paguanjë
Në faqen 17

SKANDALI NE QSUT
Mungon ilaçi për trajtimin e cirrozës, i ri: Një pako kushton 50 mijë lekë
Në faqen 12

PIKET PER KANDIDATET
Infermierët, lista me fituesit në Dibër, Lezhë, Shkodër, Kukës dhe Durrës
Në faqen 13

SHESHI "SHEN PJETER"

Polovina: Prilli i '68, si e tronditën Romën antikomunistët në festimet për Skënderbeun
Në faqet 14-15

Shpërthim në shtëpinë e Klodian Selimit, i dënuar për vrasjen e Ibrahim Bashës. Flasin banorët **Vrasja e efektivit të RENE-s, plas tritol në Lazararat**
Babai i të dënuarit: U terrorizua, s'kam konflikte me askënd

Nga BRIKENA METAJ
Tronditet Lazarati. Banesa e një prej të dënuarve për vrasjen e efektivit të RENE-s, Ibrahim Basha u sulmua me tritol në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Bëhet fjalë për shtëpinë e Klodian Selimit,



i dënuar me 13 vjet burg. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 02:30. Mësohet se lënda plasëse ishte vendosur në derën e jashtme të banesës së ...
Në faqen 10

AMBASADORI I SHBA AKUZAT

Dokumenti, "Judicial Watch" akuzon ambasadorin e SHBA në Tiranë

Edi Rama kapi drejtësinë me 9 milionë \$, që Lu i dha Sorosit

"Ambasadori Lu, i lidhur ngushtë me qeverinë socialiste"

Judicial Watch", një grupim aktivistësh amerikanë konservatorë kanë publikuar së fundmi dosjen se si miliarderi George Soros përfitoi nga paratë e taksapaguesve amerikanë për qëllimet e tij politike në Shqipëri. Ky grupim ka hetuar disa nga financimet e Soros në vende të ndryshme të lindjes dhe së fundmi ka publikuar një dosje me 32 faqe si "Fondacioni për Shoqërinë e Hapur" në Shqipëri u vu në shërbim të Partisë Socialiste në pushtet dhe kryeministrit Edi Rama për të justifikuar mënyrën se si po bëhej reforma në drejtësi. Dhe kanë marrë jo pak, por të paktën 9 milionë dollarë.

"Judicial Watch" e ka bërë hetimin nisur nga interesi i saj, për të hedhur dritë se si u shpëzuan paratë e taksapaguesve amerikanë për qëllime politike të administratës së ish-presidentit Obama. Por, ky dokument nxjerr disa detaje mjaft interesante për të kuptuar mbështetjen e fortë që Edi Rama kishte nga ambasadori amerikan, Donald Lu gjatë negociatave të miratimit të reformës në drejtësi dhe sidomos gjatë krizës politike përpara zgjedhjeve të 25 qershorit 2017, kur Lu doli hapur kundër bojkotit të opozitës, citon "lapsi.al".

"Judicial Watch" thotë se dosjen me 32 faqe arriti ta marrë më 26 maj 2017, vetëm pasi ngriti një padi për lirinë e informacionit kundër Departamentit Amerikan të Shtetit. Ky i fundit fillimisht refuzoi të jepte dokumentet 31 mars 2017. Dokumentet tregojnë se si fonde të USAID u derdhën për llogari të "Fondacionit për një Shoqëri të Hapur" në Shqipëri i mbështetur nga Soros, për t'i dhënë qeverisë socialiste shumë kontroll mbi gjyqësorin. USAID ka paguar 9 milionë dollarë në 2016-ën për fushatën e quajtur "Drejtësi për të gjithë", i cili është mbështetur nga "Instituti i menaxhimit Lindje-Perëndim" sërisht në varësi të Soros. Në mars 2017, një grup prej 6 senatorësh amerikanë të kryesuar nga Mike Lee i dërguan një letër Sekretarit të Shtetit të asaj kohe, Rex Tillerson, që të hetonte nëse zyrtarë amerikanë kishin përdorur fonde e taksapaguesve për të mbështetur Sorosin në Shqipëri. Në letër thuhet: "Fondacioni për një Shoqëri të Hapur" dhe ekspertët e tij me fonde të USAID kanë hartuar të ashtuquajturin "Dokument Strategjik për Reformën në Drejtësi në Shqipëri". Disa politikanë be-



Faksimile e faqes së "Judicial Watch"

AMBASADORI I pyetur nga "Zëri i Amerikës" se si u përgjigjet këtyre kritikave, ambasadori Lu tha: "Ne nuk kemi marrë financime për 'Fondacionin Shoqëria e Hapur' dhe as kemi marrë financime prej saj. Kritikët e reformës në drejtësi - thekson ambasadori Lu - i kanë etiketuar veprimet e ambasadës si të frymëzuara nga Soros".



Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu

PRESIDENTI I "JUDICIAL WATCH"

"Administrata e Obamës kaloi në heshtje të paktën 9 milionë dollarë amerikanë të taksapaguesve në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me mbështetjen e miliarderit të krahut të majtë, George Soros për një qeveri socialiste në Shqipëri. Është veçanërisht mizore që Departamenti i Shtetit lejoj operacionin 'Soros' të ndihmonte me fonde të drejtpërdrejta të taksapaguesve në grupe të tjera", - tha presidenti i "Judicial Watch", Tom Fitton.

Raportuesi i PE për Shqipërinë: Një demonstratë nuk ndikon në raport

Fleckenstein: Po të bllokoja rrugët në vendin tim, qytetarët do më vrisnin



një gjë që nuk bëhet. Nëse unë do të bllokoja trafikun në qytetin tim, qytetarët do të më vrisnin". Eurodeputeti Fleckenstein tha se BE

pret një rekomandim të qartë dhe të pakushtëzuar për hapjen e negociatave për Shqipërinë. "Jemi në pritje të raportit të komisionit. Është një 6-mujor tejet i rëndësishëm. Takimi i Sofjes duhet të dalë me elemente tepër konkrete. Do të presim në qershor takimin e Këshillit Evropian dhe shpresojmë të dalim me një rekomandim të qartë. Presim një rekomandim të qartë dhe të pakushtëzuar për hapjen e negociatave për Shqipërinë tani", tha ai. "Jam taksuar me palët

politike dhe ministrin e Brendshëm në Tiranë. Shqipëria ka shumë punë për të bërë sa u takon reformave. Ne do të ofrojmë mbështetjen tonë. Shpresoj që shtatorin e ardhshëm të kemi arsye për të festuar, por edhe të përgatitemi për punën që na pret", u shpreh eurodeputeti. Sa i përket reformës në drejtësi, raporteri për Shqipërinë tha se, "sa më shumë të zbatohet reforma në drejtësi, aq më e afërt është koha për hapjen e negociatave".

sojnë se këto "reforma" kanë si qëllim t'i japin kryeministrit dhe qeverisë së tij të qendrës së majtë një kontroll të plotë mbi drejtësinë". Në parlamentin shqiptar, opozita e ka përmendur shpesh se kjo "strategji" është një reformë e sponsorizuar nga Soros.

MEMO

Të dhënat e reja të "Judicial Watch" zbulojnë një "memo" të prillit 2016 nga ambasada amerikane në Ti-

ranë, që tregon se ka "sponsorizuar" një sondazh në bashkëpunim me "Fondacionin për një Shoqëri të Hapur" të Sorosit për të matur te qytetarët shqiptarë "njohuritë, mbështetjen dhe prishmërinë nga reforma në drejtësi". Fondacioni i Sorosit raportoi më pas se 91% e shqiptarëve e "mbështetnin plotësisht" apo "e mbështetnin disi" nevojën për një reformë në drejtësi. Sondazhi nuk e specifikon-

te se çfarë lloj reforme kërkohet. Një tjetër dokument i shkurtit 2017 tregon se si Departamenti i Shtetit bashkëfinancoi një tjetër sondazh të "Fondacionit për Shoqërinë e Hapur" për reformën në drejtësi, që forconte kontrollin e qeverisë shqiptare mbi reformën. Raporti tregonte se departamenti për marrëdhënie publike në ambasadën amerikane në Tiranë dhe fondacioni i Soros' mbështetën orga-

nizata lokale për të orientuar opinionin publik mbi reformën në drejtësi. Të dhënat tregojnë se DASH i dha organizatës së Sorosit fonde direkte për programet në Shqipëri. Një raportim në 10 shkurt 2017 thotë se "si një nga ofruesit më të mëdhenj të ndihmës në Shqipëri, përfaqësuesit e 'Fondacionit të Shoqërisë së Hapur' kërkojnë të marrin pjesë në shqyrtimet teknike të aplikimit që jepen për finan-

cim". "Ambasadori i SHBA-ve në Shqipëri, Donald Lu, i administratës së Obamës, ka qenë i lidhur ngushtë me Sorosin dhe qeverinë socialiste në Shqipëri. Në maj 2017, Lu ndihmoi të minojë planet e partive opozitare shqiptare për të protestuar ndaj zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, duke deklaruar se SHBA do të pranoni rezultatet e zgjedhjeve edhe në qoftë se partitë e opozitës refuzonin të merrnin pjesë. Lu është përkrahur në shtypin amerikan si një forcë shtytëse nga pas e reformës në drejtësi në Shqipëri, - shkruan "Judicial Watch". "Administrata e Obamës kaloi në heshtje të paktën 9 milionë dollarë amerikanë të taksapaguesve në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me mbështetjen e miliarderit të krahut të majtë, George Soros për një qeveri socialiste në Shqipëri. Është veçanërisht mizore që Departamenti i Shtetit lejoj operacionin 'Soros' të ndihmonte me fonde të drejtpërdrejta të taksapaguesve në grupe të tjera", - tha presidenti i "Judicial Watch", Tom Fitton.

"George Soros është një miliarder dhe ai nuk duhet të marrë mbështetjen e taksapaguesve për të çuar përpara axhendën e tij radikale të majtë për të minuar lirinë brenda dhe jashtë vendit", - shton ai.



Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu foli dje me emra konkretë për peshqit e mëdhenj, për të cilët tha se tashmë janë në rrjetë. Gjatë intervistës në emisionin "Opinion" me gazetarin Blendi Fevziu, Lu foli edhe për marrëdhëniet me Adriatik Llalën.

Në dy ditët e fundit, për shembull, kemi parë dëgjeten e toll-ëve në autostradën midis Shqipërisë dhe Kosovës, ndër-tuar 9 vjet me parë. Kemi parë protestën përpara Drejtorisë së Policisë në Tiranë. Dua t'ju pyes për vendimin e qeverisë për të dhënë me koncesion autostradën midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe për të pasur një tarifë toll prej 5 euro për një drejtimit për njerëzit, përfshij popullsinë në Kukës...

Në Shqipëri, të gjithë qytetarët kanë të drejtën të protestojnë paqesisht, përfshij në Kukës. Dhe e kuptoj njerëzit në Kukës janë të inatosur. Nuk kanë të drejtë të shkojnë të dëgjen kabinetin e toll-ëve, nuk kanë të drejtë të guajmë me gurë policinë. Në të njëjtën kohë, policia nuk ka të drejtë të lëndojë protestuesit apo të kapin njerëzit për arrestime masive në mes të natës. I kam bërë thirrje kryeministrit dhe kreut të opozitës që tani të tregojnë vetëpërbajtje, që secili të ruajë qetësinë dhe që kjo të zgjidhet me anë të dialogut.

Por reagoni i opozitës në vend, Ambasador, PD dhe LSI, kanë bërë thirrje për mosbindje civile. Nuk është hera e parë, në fakt, edhe në 2016 bënë thirrje për një protestë të tillë. Çfarë mendoni për këtë vendim të opozitës?

Në çdo demokraci, njerëzit duhet të ngrënë zërin. Po ashtu, kanë të drejtë që në mënyrë paqësore të mos lejojnë qeverinë e tyre të kryejë abuzime, por duhet ta bëjnë këtë paqesisht. Nëse do të bllokohen rrugët, të mos paguajnë taksa, apo të bëjnë vepripantari të tjera të jashtëligjshme, duhet të jenë të përgatitur për pasojat ligjore. Shtetet e Bashkuara kanë një traditë të gjatë me mosbindjen civile, por ata persona, ata protestues kanë qenë të përgatitur të shkojnë në burg për bindjet e tyre.

Opozita mendon se qeveria nuk dëgjon për asgjë. Gjërat që kërkojnë ata janë gjëra që kërkojnë njerëzit. Çfarë mendoni në këtë rast? Sepse kemi një përplasje të madhe për këtë: opozita thotë se qeveria nuk reagon ndaj kërkesave të njerëzve dhe qeveria thotë se opozita po përdor disa probleme lokale për të luftuar qeverinë.

Kam parë që Edi Rama ka bërë thirrje për dialog në këtë rast. E mbështes këtë. E mbështes zgjidhjen e kësaj çështjeje me dialog. Opozita ka thënë s'ka dialog nëse nuk lironi njerëzit nga burgju. Epo, të shohim nëse do ndodhë kjo. Mendoj se tani ka një çështje ligjore kundër personave që dogjën kabinetin e toll-ëve. Nuk e di nëse Edi Rama mund që thjesht t'i thotë gjykatës të lirojë njerëzit nga burgju.

Kur do të dënohen këta persona për problemet që kanë shkaktuar?

Besoj, kam besim se do të ndëshkohen shumë shpejt. Shumica e peshqve të mëdhenj janë në det. Pak janë tashmë në rrjeta, por shoh të dhëna që shumë shpejt do të kemi më shumë rezultate. Më lejoni të jem specifik këtu. Met Kanani është një trafikant droge irrezikshëm, trafikant shqiptar, arrestuar në Bodrum, Turqi, dy javë më

Akuzat për Soros, ambasadori i SHBA: Të pavërteta. Nuk i kemi dhënë para

Lu: Klement Balili, në Shqipëri mund të arrestohet në ditët në vijim

"Protestat, opozita e qeveria të ruajnë qetësinë"

parë, me ndihmën e qeverisë shqiptare.

Ai u zhduk ...

U zhduk, por tani ka një mandat arresti ndërkom-bëtar për të dhe Shqipëria po e kërkon kudo në Europë dhe ne po ndihmojmë për këtë. Klement Balili, po ashtu me mandat arresti ndërkom-bëtar. Ne, amerikanët, besojmë se është ende në Shqipëri dhe ka mundësi të arrestohet në ditët që vijmë. Po shtyjme shumë fort për këtë. E dini, Z. Balili është dënuar tashmë në Greqi për trafik droge.

Po, ata janë gangsterët, personat e trafikëve, dhe të tjerët. Unë flas për personat e fuqishëm, me kostume, me kostume shumë të shtrënjta, të cilët qëndrojnë çdo ditë në bare e restorantet e Tiranës dhe nuk ndëshkohen kurrë.

Vitin e kaluar, nuk kishte hetime, me sa di, kundër këtyre trafikantëve të mëdhenj të drogës apo zyrtarëve të lartë. Çfarë kemi sot? Mendoj se është shumë interesante. Shikoni çështjen kundër Adriatik Llalës. Ka shumë në media tani lidhur me këtë çështje. Po hetohet për korrupsion. Qeveria e SHBA po ndihmon në atë hetim. Shikoni Saimir Tahiritin - ish-ministri i Brendshëm shumë i fuqishëm. Po hetohet dhe besoj se jemi pranë ndjekjes penale në këtë çështje. Fran Frrokaj, kryebashkiaku i Lezhës...

Cili është pozicioni i Qeverisë së SHBA?

Se çështja kundër Saimir Tahirit meriton të vendoset nga një gjykatës, jo të vendoset nga politikanët, jo të vendoset nga prokurorët që nuk bëjnë punën, por duhet të vendoset nga një gjykatës që do të shohë me transparencë provat e çështjes. Kemi parë tashmë në media shumë prova.

Zoti Ambasador, do t'i kthehem vettingut, por doja t'ju pyesja për historinë tuaj me ish-Prokurorin e Përgjithshëm, z. Llalla. Përse Departamenti i Shtetit ia ndaloj hyrjen z. Llalla dhe familjes së tij në Shtetet e Bashkuara?

Sekretari i Shtetit vendosi që z. Llalla do të ishte i pari person në botë, që sipas këtij ligji që i lejon Presidentit të Shteteve të Bashkuara t'i ndalojë hyrjen në Shtetet e Bashkuara një zyrtari të korrupsionit nga një vend tjetër.

Sipas informacioneve të kujt?

Më lejoni të mbaroj. Pra, mbështetje në korrupsion të konsiderueshëm. Prandaj ne, qeveria e SHBA, dhe në këtë rast Sekretari i Shtetit, i cili nën autoritetin e Presidentit për këtë çështje, ishte i bindur se kishte prova të mjaftueshme për të besuar se z. Llalla ishte i përfshirë në korrupsion të rëndësishëm. Këtu ngrihet edhe një pyetje



Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu dje në emisionin "Opinion" me gazetarin Blendi Fevziu

tjetër, nëse ai ka shkelur ligjet e vendit tuaj. Nuk mund ta vendosim ne këtë për Shqipërinë, ne nuk jemi zbatuesit shqiptarë të ligjit. Prandaj po punojmë me prokurorët dhe policinë shqiptare, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë atë që ne kemi kuptuar, në mënyrë që të vendosim nëse duan ta çojnë këtë çështje në gjykatë.

Shumë njerëz besojnë se ishit ju që personalisht e dënuat Llalën për shkak të problemeve që kemi pasur më parë.

Asnjë President i Shteteve të Bashkuara apo Sekretar Shtetit nuk do mjaftohet vetëm me të dhënat e Ambasadorit Amerikan. Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka shumë burime informacioni, dhe të gjitha ato të çonin në një përfundim, dhe ai ishte përfundimi ku Sekretari i Shtetit i mbështet për vendimin e tij.

Cili ishte problem më i madh i z. Llalla?

Prokurori i Përgjithshëm Llalla nuk ndoqi penalisht njerëzit. Ai ishte prokurori më i lartë në vend, e megjithatë askush nuk u fut në burg gjatë mandatit të tij. Ju keni nivelin më të ulët të ndjekjeve penale për krimet e rënda në një vend me probleme serioze me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Prandaj shpresoj që të gjithë Prokurorët e Përgjithshëm të ardhshëm, përfshirë edhe zj. Marku, ta marrin më seriozisht përgjegjësinë e tyre për të ndjekur penalisht njerëzit që shkelin ligjin.

A e ka mbështetjen tuaj Arta Marku, Prokurorja e Përgjithshme e përkohshme? Mbështetjen e SHBA, jo tuajen personalisht.

Askush nuk e ka mbështetjen e Shteteve të Bashkuara përveç zyrtarëve tanë. Por unë jam taksuar disa herë me zj. Marku dhe mendoj se ajo është një profesioniste serioze dhe e kualifikuar, e cila po përpiqet të bëjë një punë të mirë për gjatë muajve të saj si Prokurorë e Përgjithshme e përkohshme. Kam parë, gjithashtu, se gjatë kësaj kohe, prokurorët kanë nisur disa ndjekje penale ndaj figurave të opozitës, e kam

parë edhe këtë. Znj. Marku më ka thënë mua, por e ka thënë edhe publikisht se ajo është shumë e zotuar dhe mbështet hetimin ndaj Saimir Tahirit. Ky është një çast i rëndësishëm kur znj. Marku dhe sistemi mund të vërtetojnë nëse ky hetim mund të ecë përpara pa ndërhyrjen e politikës. Do thosha, gjithashtu, se po ndjekim nga afër edhe hetimin e Elvis Roshit, një tjetër socialist, për të parë nëse ai do të trajtohet njësoj si njerëzit e opozitës. Jemi të interesuar të shohim më shumë ndjekje penale në radhë të shumicës, dua të jem shumë i qartë për këtë. Ka njerëz të cilët, unë besoj se meritojnë të ndiqen penalisht dhe qeveria e SHBA është gati të mbështesë znj. Marku, prokurorët dhe policinë në këto çështje.

Në Shqipëri ka një debat të madh për një kontratë PR nënshkruar nga PD dhe një person në SHBA që është një kompani PR në SHBA. U botua nga Mother Jones një investigim që thoshte se ato para vinin nga Rusia dhe nga Kremlin. Cili është opinioni juaj, e para, dhe e dyta, a ka një hetim në SHBA për këtë çështje? Nuk flas për hetimin e madh për ndikimin rus në zgjedhjet e SHBA.

Ne, qeveria e SHBA dimë shumë për këtë çështje. Në SHBA, lobimi pranë qeverisë së SHBA është i ligjshëm, përfshij lobimin nga entet e huaja, fuqi të huaja, në këtë rast një parti politike. Por për të lobuar në Shtetet e Bashkuara në mënyrë të ligjshme, lobisti duhet të bëjë deklaratime publike të kontratave, të financave dhe të aktiviteteve që ndërmer, në këtë rast për PD. Pra, çdo gazetar, çdo qytetar mund të hyjë në faqen e Departamentit të Drejtësisë dhe të gjejë të gjitha këto hollësi, të gjitha kontratat, dhe shifrat. Pra, dimë shumë dhe kemi ditur, në fakt, për gjashtë muaj se çfarë ndodh me këtë rast. Janë dy çështje këtu. Njera çështje është nëse janë shkelur ligje në Shtetet e Bashkuara apo në Shqipëri. Në SHBA mund ta dini se kemi ligje kundër të huajve që ofrojnë para për fushata

politike. Në Shqipëri, dimë që Luli Basha ka kërkuar nga prokuroria të hapin një hetim. Kanë hapur një hetim dhe janë në proces për t'i kërkuar SHBA, qeverisë së SHBA dhe prokurorëve të SHBA, për dokumente për këtë çështje. Pra, ka një hetim të hapur në Shqipëri. Nuk mund të konfirmoj nëse ka një hetim të hapur në Shtetet e Bashkuara.

Megjithatë, gjëja e dytë për të cilën dua të flas është çështja e Rusisë, sepse qeveria e SHBA dhe ambasada jonë janë shumë të shoqësuara për prova në rritje të ndërrhyrjes ruse në zgjedhje kudo në Europë. Po e ndjekim çështjen nga shumë afër, nëse rusët kanë dhënë kontribute tek lobisti në emër të Partisë Demokratike dhe Luli Bashës. Nëse kjo është e vërtetë, do të ishte një përpjekje shumë serioze nga rusët për të ndërhyr në zgjedhjet e një shteti anëtar të NATO-s.

Ka shumë njerëz në Shqipëri që mendojnë se George Soros, miliarderi amerikan, po ndërhyr në punët e brendshme të Shqipërisë nëpërmjet Fondacionit Soros dhe nëpërmjet mbështetjes për qeverinë. Cili është opinioni juaj për këtë ide?

Më lejoni t'i përgjigjem në dy mënyra pyetjeje. E para, më duhet të them se Fondacioni Soros është një fondacion privat, nuk është një ent i qeverisë së SHBA, në asnjë mënyrë, pra si ambasador amerikan ku do të ishte e pavennd për mua që goftë të mbështesja aktivitetet e Fondacionit Soros apo të kritikojta ato. Janë disa politikamë shqiptarë që kanë pretenduar se unë, Ambasadori i SHBA, ose ne, Ambasadori e SHBA, në ndonjë mënyrë, kemi financuar Sorosin këtu apo kemi mbështetur veprimtaritë e tyre në Shqipëri. Është tërësisht e pavërtetë. Dhe nuk janë vërtet i sigurt se pse vazhdojnë ta tregojnë këtë histori. Nuk ka pasur para amerikane që shkojnë tek Fondacioni Soros në Shqipëri. Është e vërtetë që Soros ka programe këtu, e dini ju, e di edhe unë. Hera-herës, këto programe kanë objektivitet të përbashkëta me programet e qeverisë së SHBA. Shembulli më i dukshëm është reforma e gjyqësorisë, apo jo? Ata financuan një pjesë të punës kërkimore për reformën në hapat e parë, qeveria e SHBA ka investuar fuqishëm për atë reformë, por këtë kanë bërë edhe socialistët, edhe demokratët, edhe LSI, edhe europianët, është projekt i përbashkët. Ka rastet, kur Fondacioni Soros ka zhvilluar programe të tjera këtu me të cilat ne, qeveria e SHBA, nuk kemi qenë në një mendje. Është fondacion privat, nuk ka të bëjë me qeverinë e SHBA.

PROTESTA OPOZITA

Digjen gomat e makinave, incidenti i vetëm dhe përplasja me policinë në Milot

Mosbindja civile, opozita bllokoi rrugët për dy orë

Kreu i PD-së, këmbëkryq në mes të autostradës

Valentina Madani

Opozita protestoi dje paqesisht kundër tarifës për Rrugën e Kombit. Prej orës 10:00 deri në orën 12:00 deputetë të opozitës dhe mbështetësit u mbledhën në 4 kryqëzime kryesore të vendit: Vorë, Bradashesh, Milot dhe Çermë, duke bllokuar lëvizjen e automjeteve dhe duke i kërkuar Ramës të lirojë të arrestuarit e protestës së Rrugës së Kombit, të heqë tarifën e kalimit si dhe të heqë TVSH-në për biznesin e vogël. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha dhe Luan Rama i LSI-së ishin në Vorë, ku u ulën këmbëkryq me protestuesit në autostradën Tiranë-Durrës, ndërsa kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi ishte në Bradashesh të Elbasanit, ku protestuesit u vunë flakën gomave të makinave. Edhe në Milot ku ishte deputeti demokrat Flamur Noka u dogjën gomat e makinave. Në Çermë të Lushnjës ishin deputetët Enkelejd Alibeaj dhe Myslym Murri. Segmenti i parë rrugor që u bllokua nga protestuesit ishte kryqëzimi në Vorë. Protestuesit dolën në autostradë, por edhe në rrugët dytësorë në orën 9 e 40, duke mos lejuar kalimin e automjeteve. Mes qytetarëve ishin deputetët e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, ndërsa pak minuta më vonë u bashkua edhe Lulzim Basha bashkë me bashkëshorten Aurela. Protesta ishte e qetë, ndërsa Basha e shfrytëzoi për të diskutuar me qytetarët. Nuk munguan as foto selfie. Për t'u çlodhur, Basha u ul me protestuesit këmbëkryq në mes të autostradës. Policia qëndronte larg dhe nuk ndërhyri për asnjë moment. Ndërsa kishin qytetarë apo drejtues automjeteve të bllokuar që shikonin me kureshtje protestën, kishin nga ata që e shfrytëzuan kohën edhe për gjumë. Kishin edhe të revoltuar, pasi nuk kishin arritur të mbyllnin punët e tyre qoftë edhe për ceremoni mortore. Në Milot protestuesit e opozitës janë përplasur me

policinë pas bllokimit të rrugës kryesore. Policia nuk lejoi që të bllokohet rruga, ndërsa Flamur Noka e cilësoi

si provokim reagimin e forcave të rendit. "Ja kam komunikuar policisë. Ky është provokim që bën policia, Edi

Rama ka uzurpuar shtetin", tha Noka. Ndërsa Bardh Spahia shtoi se, "protesta është paqësore dhe policia të mos provokojë". Ndërkohë që pas disa momenteve tension, situata është qetësuar, por rruga qëndroi e bllokuar deri në mbylljen e protestës. Në funksion të kësaj proteste opozita kërkoi që seanca plenare e parashikuar në orën 10:00 të shtyhej në orën 18:00. Ndërkohë, grupi parlamentar i LSI kërkoi nga Gramoz Ruçi që të përjashtojë nga punimet e Kuvendit kryeministrin Edi Rama, pasi ata pretendojnë se në seancën parlamentare të kaluar Rama ka përdorur fjalor fyes ndaj opozitës dhe qytetarëve, pas protestës në Rrugën e Kombit.



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha gjatë protestës së djeshme

BLLOKIMI

Të bllokuara ishin kryqëzimi i Milotit, i cili lidh Tiranën me Shkodrën, por edhe Rrugën e Kombit me Tiranën dhe Durrësin. Gjithashtu, është bllokuar edhe kryqëzimi i Çermës në Lushnjë, që bllokoi lëvizjen në jug të vendit, kryqëzimi i Vorës dhe i kryqëzimi i Bradasheshit në Elbasan.

Policia: Protesta e opozitës, e paligjshme

Mosbindja civile e opozitës, Xhafaj vlerëson qytetarët dhe policinë

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj falënderoi dje qytetarët që nuk shkakuan incident gjatë protestës së zhvilluar nga opozita. Në një status në "Twitter", Xhafaj vlerëson durimin e treguar, duke edhe policinë për menaxhimin e situatës. "Për rreth 2 orë qindra qytetarë mbetën të bllokuar në 4 akse kryesore rrugore, për shkak të protestës së paligjshme të zhvilluar nga opozita. Policia bëri të gjitha përpjekjet për të lehtësuar lëvizjen në rastet e emergjencës. Falënderojmë qytetarët për durimin e treguar, duke mos shkakuar asnjë incident, me gjithë vonesën dhe problemet që iu solli

PASQYRIMI

Thirrja e opozitës për mosbindje civile është pasqyruar edhe nga mediat ndërkombëtare. "Reuters" shkruan se protestuesit shqiptarë bllokuan rrugën, duke kërkuar që t'i jepet fund tarifës për Rrugën e Kombit. Kurse "Associated Press" vë në pah thirrjen e opozitës për mosbindje civile.

ky bllokim. Vlerësim maksimal drejtuesve dhe strukturave vendore të Policisë së Shtetit për menaxhimin profesional të situatës së pazakontë", shprehet z.Xhafaj. Policia e Shtetit paralajmëroi më herët se protesta është e paligjshme. Në një deklaratë, policia shprehej se kjo është bërë e njohur nga media, ndërsa nuk ka

marrë njoftim ligjor për protestën dhe mbështetur në ligjin "Për tubimet", nuk mund të lejohet protesta të askujt, që në emër të lirisë së tubimit, cenojnë lirinë e sigurinë e të tjerëve. Policia e Shtetit deklaroi se një dhe respektin si të paprekshme të drejtën për të protestuar, por ajo ka përgjegjësi ligjore, si dhe gatishmërinë



Mesazhi

EDMOND SPAHO

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho, tha se qytetarët treguan se u është sosur durimi. "Mesazhi që Rama duhet të kuptojë është që ne duam të jetojmë këtu. Kjo është rrugë pa kthim. Sot i dhamë mesazhin e parë. Në ditët dhe javët e ardhshme rezistenca do të jetë shumë më e ashpër derisa të arrijmë objektivin që të shporrim këtë të keqe nga Shqipëria. Ai duhet të ikë nga Shqipëria dhe jo shqiptarët. Mirupafshim në manifestimin e ardhshëm", theksoi z.Spaho.



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

për të mos lejuar cenimin e interesit të qytetarëve. Në deklaratë thuhet: "Policia e Shtetit u bën apel të gjithë qytetarëve të mos bienin pre e një politike të angazhuar për të goditur ligjshmërinë dhe institucionet e vendit, duke dëmtuar interesat e njerëzve e të vetë vendit. Zhvillimi i një proteste të paligjshme mund të përdoret nga elementë me precedentet kriminale dhe të nxjerrin a të paguar

për të krijuar paqëndrueshmëri shoqërore", thuhet më tej në deklaratë. Duke e konsideruar si të rrezikshme për rendin dhe sigurinë, policia i bën thirrje çdo qytetari të mos bëhet pjesë e kësaj proteste. Gjithashtu, Policia e Shtetit i kërkoi paraprakisht ndjesë çdo qytetari, për çdo rast kur nuk do të mund t'i shërbejë si duhet lirisë së qarkullimit.



Valentina Madani

Partia Demokratike nuk do të tërhiqet deri në heqjen e taksës për Rrugën e Kombit. Pas protestës duke bllokuar katër akse nacionale gjatë paradites së djeshme, pasdite drejtuesit e opozitës u mblodhën në selinë e Partisë Demokratike. Kreu i PD-së, Lulzim Basha bashkë me aleatët e djathtë diskutoi mbrëmë për rrugën që do të ndiqet në protestat kundër qeverisë "Rama". Në tryezë u diskutua me të gjitha strukturat për ngritjen e një plani të përgjithshëm veprimi. Kreu i PD-së para gazetarëve falënderoi qytetarët që dolën në protestë, por duke thënë se kryeministri Edi Rama nuk është tërhequr. Sipas tij, Rama ka pranuar fajin, por për sa kohë mban në burg 11 të pafajshëm, nuk është tërhequr. "Edi Rama ka pranuar fajin sot, por sa kohë mban në burg 11 të pafajshëm, nuk është tërhequr. Ndaj i bashkohemi kërkesës së qytetarëve të Kukësit, Hasit e Shqipërisë për lirinë e 11 pengjeve të fajit të Edi Ramës. Ndonëse ka pranuar fajin, nuk përballat me pasojat. Duhet të anulohet menjëherë taksën korruptive. Të japë llogaritë për urdhrat e paligjshëm me të cilët ka rrëmbyer qytetarët në shtëpitë e tyre. Sa kohë që kjo nuk ndodh, opozita do vazhdojë të qëndrojë në krah të qytetarëve. Kjo krizë ka shpalosur një të vërtetë të dhimbshme, që opozita ka muaj që e thotë. Rama nuk është kryeministër i vendit, por autokrat i që kontrollon. Ka privatizuar policinë që iu bind urdhrat të Ramës për të grabitur në mes të natës qytetarët, por nuk kap dot Arbër Çekajin. Kjo polici u ngrit në këmbë me urdhrat e Edi Ramës dhe arrestoi 23 të pafajshëm, 11 prej të cilëve mbahen në burg", tha z.Basha. Më herët mes protestuesve në Vorë, Basha tha se deklarata e Ramës në Kuvend nënkupte pezullim të taksës dhe jo tërheqje nga taksimi. Basha i kërkoi kryeministrit të anulohet tërësisht taksën në këtë rrugë. "Taksa të anulohet tërësisht, Rama të heqë taksën se është e padrejtë për çdo shqiptar, është një taksë e dyfishtë. Shqiptarët paguajnë plot 200 milionë euro për rrugët. Të marrë fund ky shtet, i cili është në shërbim të kriminelëve. Do vazhdojmë deri në fund. Fitorja është kur shteti dhe institucionet të kthehen në shërbim të qytetarëve", tha z.Basha. Për kryetaren e LSI, Monika Kryemadhi, protesta 2-orëshe e opozitës dhe qytetarëve ishte fillimi i fundit të kryeministrit Rama. Nga Elbasani, Kryemadhi paralajmëroi Ramën se protesta nuk do të ndalojë derisa ai të tërhiqet nga taksat me të cilat po i merr shpirtin shqiptarëve. Monika Kryemadhi i bëri thirrje kryeministrit Edi Rama që të lirojë nga burgu kuksianët e arrestuar për protestën në Rrugën e Kombit. Duke theksuar rëndësinë e protestës, nga Elbasani kryetarja e LSI tha se nuk do

Opozita mblidhet pas bllokimit të rrugëve, vendoset për zgjerimin e protestës

Basha: Rama i pabesueshëm, heqje dhe jo pezullim të taksës

Kryemadhi, Ramës: S'ka ambasador që të shpëton



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, dje në protestë



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, dje në protestë

THIRRJA
Nga Miloti, ku ishte pjesë e protestës, kryebashkiaku i Kukësit, Bashkim Shehu deklaroi: "I bëjmë thirrje kryeministri Rama të lirojë menjëherë protestuesit e arrestuar, janë hallexhinj. Qytetarët kanë të drejtë të protestojnë, organet shtetërore duhet të sigurojnë protestat. Rama të shikojë dhe të bëjë punët e tij të përditshme, pasi qytetarët nuk mund të durojnë më".

PROTESTA



Alibeaj: Qeveria të lexojë revoltën

Deputeti demokrat, Enkelejd Alibeaj nga Çerema tha dje se qytetarët po vendosin në zbatim planin e Edi Ramës për të refuzuar dhe larguar qeverinë "Rama". "Janë njerëz që duan të tregojnë vetëm një gjë: refuzojnë këtë qeveri nga fillimi deri në fund! Ky është plani i shqiptarëve, që nuk ka asgjë të ngjashme me planin e Edi Ramës për t'u marrë edhe pikën e fundit të gjakut. Plan që shqiptarët duan të fitojnë lirinë. Ky është hapi i parë i mosbindjes civile", deklaroi Alibeaj. Ai tha se opozita do të jenë në krah të qytetarëve. "Sytë qorr dhe veshët shurdhë të qeverisë të lexojnë këtë revoltë. Për lirinë, çfarëdo lloj sakrificë e publikut është e justifikuar", u shpreh deputeti i PD-së.

Berisha për Ramën: Në parlament, si këlysh i rrahur

Deputetët e opozitës "kanë braktisur" sallën e sean cave plenare këtë të enjte, për t'iu bashkuar protestës së qytetarëve në katër akse rrugore kryesore të vendit. Por, ndonëse ka munguar në këtë seancë parlamentare, ish-kryeministri Sali Berisha nuk e ka kursyer ironinë ndaj kreut të qeverisë. "Rama, në parlament si këlysh i rrahur, frymëzënë mban fjalimin. Gjej by... vend ku të futësh! Nderim heronjve të Kalimashit! sb", shkruan Berisha. Ai publikoi edhe një karikaturë, ku tregon se populli i ka dhënë "goditje" kryeministrit për tarifën e lartë në Rrugën e Kombit. Po dje ish-kryeministri ironizoi komunikimin 'online' të kreut të qeverisë me lumjanët. "Besomëni mua o kuksianë në qoftë se nuk vij dot t'ju takoj direkt, fajin nuk është i imi! Madje as i atij që e ka gjithmonë fajin! Jo, jo! Fajin e keni ju! Më thyet hundën pa hyrë në lojë, ju qofshi! Ju qofshi se zemrën nuk e kam në zorrën e hollë, por në zorrën e trashë! Harrojeni taksën, nuk kam pasur kurrë ndërmend ta vër për ju", - tha Berisha.

të tërhiqet derisa kërkesa e qytetarëve të plotësohet. Sipas saj, Rama është zhytur në zullumet e tij sa që nuk ka prokurorë, policë e ambasadorë që ta shpëtojnë. "Rama mori një mësim shumë të mirë, por ky është vetëm fillimi i fundit të tij. Ai e di shumë mirë që po nuk u tërhoq nga taksa e Rrugës së Kombit, po nuk liroi djemtë kuksianë, po nuk hoqi TVSH për biznesin e vogël, po nuk riktheu në listën e ndihmës ekonomike mbi 20 mijë familje, po nuk hoqi taksën e pronës, po nuk uli çmimin e ujit dhe të gjitha taksat që po u marrin shpirtin shqiptarëve për të pasuruar dhe fryrë xhepat e tij dhe oligarkëve, kjo protestë nuk do të ndalojë. Nuk i mbetet gjë tjetër vetëm tërheqja nga rruga ku ka hyrë dhe të largohet një orë e më parë ethe e tij të përfshirjes dhe uzurpimit ju vetëm të drejtësisë dhe policisë, por edhe nga tavolinat e shqiptarëve që kërkon t'u rrëmbejë kafshatën e fundit", deklaroi zj. Kryemadhi.

Protesta të tjera, Ristani: Tërheqja e Ramës, "lot krokodili"

Sekretari i përgjithshëm i PD-së, Arben Ristani sparalajmëroi dje se, "opozita do të vazhdojë të protestojë, nuk do të ndalemi". I ftuar në rubrikën "Opinion" në "News 24", sekretari i përgjithshëm PD-së, Arben Ristani u ndal tek protesta e dhe-sjme që zhvilloi opozita por edhe qytetarë, të cilët bllokuan disa akse kryesore në vend, në shenjë kundërshtie për taksën. Ristani u shpreh tryeza e opozitës do të vendosë hapat e mëtejshme të protestave. Mes të tjerash, ai komentoi edhe vendimin e kryeministrit për t'u tërhequr nga taksa për Rrugën e Kombit, ndërsa tha se tërheqja e Ramës ishte "lot krokodili". "Aksioni i opozitës është i bazuar në luftën kundër varfërisë. Do të mbështesim protestat e qytetarëve. Tërheqja e Ramës, lot krokodili. Rama mban në burg qytetarë të pafajshëm. Qytetarët kuksianë u rrëmbyen në mes të natës. Ndalimi i protestuesve, pa asnjë procedurë. Do ketë protesta në mënyrë absolute", tha Ristani

Fondacioni "Islamic Relief Worldwide" e ka zanafillën në Shqipëri në vitin 1991. Islamic Relief- Albania office është rregjistruar si një organizatë ndërkombëtare në Shqipëri me vendim gjykatë nr. 44 me 14 Korrik 1994. Aktualisht Fondacioni operon në rrethet Shkodër e Tiranë, në qytetin e Pogradecit, Korçë, Kavajë dhe atë të Lushnjes me projekte të ndryshme zhvillimore në sektorët e edukimit, infrastrukturës, rritjes së kapaciteteve, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, shëndetësisë dhe në projekte sezonale si Qurbani dhe Ramazani.

FTESE PER OFERTE

06.04.2018

Fondacioni Islamic Relief- Albania Office ka hapur ftesën për ofertë me objekt:

"BLERJE PRODUKTESH USHQIMORE"

Parashikohen te përgatiten rreth 2900 pako ushqimoresh, 1 pako ushqimesh do të përmbajë: Orize 3kg, Makaronë 2.5kg, Sheqer 2kg, Miell 3kg, Vaj Luledielli 4 Liter, Reçel 720gr (2 vazò), Fasule 1kg.

Per detaja ne lidhje me kerkesat per kete ftese ne tender, klikoni ne faqen zyrtare te Facebook: Islamic Relief Albania

Oferta juaj duhet të jetë në një zarf të mbyllur dhe të vulosur dhe duhet dërguar në adresën:
Adresa: Laprake, rruga e Durrësit, Bloku Gintash, pall E, kati i II, ap 8, Tirana ose mund ta dergoni ne posten elektronike: info@islamicrelief.al
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është më datën 16.04.2018.
Për çdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni në: info@islamicrelief.al ose te kontaktoni ne:

Tel.: +355 42413190, 0673453330

PARLAMENT KRYEMINISTRI

Kryeministri u kërkon ndjesë kuksianëve: Duhet ta kishim sqaruar

Taksa e Rrugës së Kombit, tërhiqet Rama: S'ka pagesë pa gjetur zgjidhje

"Shpejt do shihni ç'e shtyn opozitën të bëjë kaos"

Darina Tanushi

Kryeministrit Edi Rama u tërhoq dje, nga vendosja e pagesës për Rrugën e Kombit, derisa të gjendet një zgjidhje e pranueshme për banorët e zonës që e përdorin më shpesh atë rrugë. Gjatë fjalës së mbajtur në Kuvend, në mungesë të opozitës, Rama tha: "Opozita nuk është këtu, sepse nuk është e motivuar nga problemi i krijuar nga vendosja e kësaj pagese, por është e motivuar për të shfrytëzuar këtë moment pakënaqësie legjitime të banorëve të zonës së Kukësit në funksion të halleve të ditura dhe të paditura të lidhshpimit të saj". "Megjithatë, duke qenë se opozita nuk është këtu, unë nuk do të merrem me "pse"-të dhe "si"-të e opozitës, që e ka humbur rrugën dhe kërkon të tërheqë sa më shumë njerëz në rrugën e saj pa krye, por do të merrem me atë që është detyra jonë e ditës, shpjegimi me durim i çështjes që ka krijuar pakënaqësinë legjitime të banorëve të zonës së Kukësit", u shpreh kreu i qeverisë. Duke pranuar përgjegjësinë se nuk kanë bërë sa duhet për ta sqaruar këtë vendim për taksën e rrugës, Rama u shpreh: "Pse kemi përgjegjësi, unë i pari, qeveria si e tërë, për akumulimin e kësaj pakënaqësie? Sepse, pa dashur aspak të justifikohem, u kam kërkuar ndjesë publike banorëve të zonës dhe do u kërkoj deri në fund, sa herë të flas për këtë temë, por jemi nisur thjesht nga praktika ndërkombejtare dhe duke qenë një eksperiencë e parë, nuk kemi qenë mjaftueshmërisht të përgatitur për çfarë mund të krijonte një risi e tillë nga pikëpamja psikologjike për njerëzit e painformuar sa duhet dhe pastaj, edhe të vendosur në shënjestrën e të tjerëve, opozitës, por jo



Kryeministrit Edi Rama

DEKLARATA



FAKTET

Kryeministri tha dje, për krerët e opozitës se "Shumë shpejt do të shikoni në dritën e diellit se çfarë i shtyn ata të dalin atje, çfarë i shtyn ata të nxisin zjarr, të nxisin rrëmuje, të nxisin kaos".



AKUZA

"Këta që ankohen për rrugën e dinë që atë koncesion e kanë dhënë këta dhe ia kanë dhënë një privati që të fusë duart në çdo xhep të çdokujt që bën kolaudimin. Ky nuk është koncesion, kjo është vjedhje", akuzoi Rama opozitën.



vetëm, për t'u përdorur si mish për top për axhendat e tyre". "Në praktikën ndërkombejtare, çka është e nënshtuar në kontratë, kërko-

Kryeministri zhvilloi dje, pas parlamentit një interpelancë me videokonferencë me qytetarë të Kukësit, të cilëve u premtoi se shumë shpejt do të përfitojnë edhe nga aeroporti, ku do të mund të zhvillohen fluturime me kosto të ulët. Në pranë edhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës, Damian Gjinkuri, Rama u kërkoj ndjesë atyre për mosinformimin e duhur dhe mosbërjen në kohë të procesit të reduktuar të tarifimit për kalimin e banorëve të zonës në Rrugën e Kombit. "Ju kërkoj ndjesë, sepse pjesa e mosinformimit të saktë është pjesë e mospërgjegjësisë tonë. Mungesa e komunikimit, jo, sepse kemi qenë indiferentë, por për një arsye, nga njëra anë, sepse nuk e vlerësuam si duhet këtë fazë dhe nga ana tjetër, qysh në fund të shkurtit kemi nisur punën për një

hen 6 muaj pas vendosjes së sistemit të pagesës për të nxjerrë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe për të trajtuar me një sistem të veçantë pagese përdoruesit e shpesh-të, që në këtë rast janë banorët e zonës. Kjo është e shkruar në kontratë", sqaroi Rama. Ai foli edhe për bisedimet që kanë bërë me

NDJESA

"Faji im po, që kur thashë atëherë alpinët, nuk thashë Salu, vajza, djali, Rrahmani, Rrahmoni, Ahmoni dhe Dermoni, që u shfaqën si trashëgimtarë pronash afër detit. Thashë "alpin", një mënyrë sipas meje ironike për t'i rënë derës që do të dëgjojë, por ajo derë nuk do të dëgjojë dhe ajo derë ka vetëm një trokitje që i bën derman, drejtësinë", kujtoi Rama.



Gjatë një seance parlamentare

DEKLARATA

"Unë nuk jam i pagabueshëm dhe me thënë të drejtën, e kam të vështirë të hesht dhe të mos reagoj përpara budallallëku dhe përpara injorancës dhe kur budallallëku me injorancën bashkohen bashkë, pastaj është kulmi. E mbase ndonjëherë mund të them edhe diçka më shumë se ç'duhet, por kurrë, nuk kam parasysh asnjë njeri të zakonshëm", tha dje, kryeministri.

Kreu i qeverisë interpelancë me qytetarë të Kukësit

"Gati aeroporti me çmime të ulëta, nuk jam tërhequr nga taksa, po bisedojmë"



pikë të kontratës, që është pikërisht për ata që quhen përdorues të shpesh-të të rrugës. Pra, për ata që rru-gatë dhe domosdoshme për

kompaninë koncesionare. "Ne jemi duke vazhduar intensivisht punën për zgjidhjen e kësaj problematike dhe për krijimin e mundësisë optimale, që edhe procesi i mirëmbajtjes jetike të Rrugës së Kombit të garantohej, edhe problemi i banorëve të adresohet. Në këtë aspekt, vendimi ynë

tërhequr nga tarifa dhe tani duhet të kërkoj lirinimin njerëzve. Jetojmë në një shtet me pushtete të ndara, se kush ndalohej e kush gjykohej nuk është vendimarrja ime, por e organeve ligjzbatuese. Thirrja për të liruar këta e ata, është një thirrje që shkon jo vetëm në adresë të gabuar, por shkon komplet në ajër", tha Rama. "Kryetari të Bashkisë Kukës i them që jo vetëm që s'jam tërhequr nga asgjë, por po vazhdojmë një proces që duhet ta kishim bërë më përpara. Për këtë kemi gabuar, kam kërkuar ndjesë. Nuk jemi si ata që bëjnë si të pagabueshëm dhe nuk kërkojnë ndjesë", u shpreh Rama.

është i qartë: Ne nuk do të fillojmë sistemin e pagesës, pa dhënë zgjidhjen më të mirë të mundshme për atë zonë", qartësoi Rama. Ndër të tjera, kryeministri tha se qeveria që drejton ka ulur taksat për 97% të shqiptarëve. "Dakord, mirë bëjnë që e kontestojnë, por duhet t'i bëjmë vetes një py-

etje: Si mundet ne ta bëjmë Shqipërinë që duam, si mundet ne të bëjmë një shtet si të gjithë të tjerët, nëse jemi të gatshëm që kur shkojmë në Maqedoni, të paguajmë pa bërë naze, se s'kemi çfarë nazesh të bëjmë, nga 0.5 euro deri në 5.5 euro në varësi të aksit rrugor?", u shpreh më tej, Rama.



Mungon opozita në Kuvend, përplasja brenda mazhorancës mes Finos e Ruçit

I refuzojnë amendimin, Majko largohet i irrituar nga parlamenti

Kodheli, qeverisë: Investo në rrugën e vjetër të Kukësit

Valentina Madani

Opozita dje po protestonte në katër akse rrugore kundër tarifës së Rrugës së Kombit, ndërkohë që në sallën e Kuvendit mazhoranca krijoi opozitën e "re" për disa orë në parlament. Deputetët votuan ligjin për diasporën, por vetë autori i këtij ligji nuk mori pjesë fare në votim. Pandeli Majko u largua nga salla e Kuvendit para votimit final të draftit. Vendimi i ministrit të Shtetit për Diasporën ishte shenjë pakënaqësie ndaj tij për rrëzimin e një amendamenti. Përpjekjet e Pandeli Majkos për një ndryshim të një neni të këtij ligji u kundërshtuan nga kolegët e tij socialistë. Bëhej fjalë për një amendim të nenit 18, që hasi në kundërshtimin e Mimi Kodheli dhe Taulant Ballës. Sipas kreut të grupit parlamentar socialist, Taulant Balla amendimi ishte jashtë afateve kohore. Vetë kryeministri Edi Rama abstenoj, ndërsa pas rrëzimit me karton, Majko u ngrit vullshëm duke shtyrë karrigen e duke braktisur sallën e parlamentit para përfundimit të votimit. Ligji për diasporën u miratua me 74 vota pro dhe vetëm një kundër, atë të Tom Doshit. Por ligji për diasporën emë pas edhe miratimi i Kodit të Etikës për deputetët nuk kaloi pa debate brenda vetë shumicës. Shkak u bë propozimi i deputetit Adnor Shame-ti, që mori mbështetje nga ministri i Diasporës, por jo nga ish-ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli. "Nuk është diskutuar në komision, ndaj mendoj që nuk duhet të futet", tha Kodheli. Por Majko para se të largohej nga salla tha: "Përkrah amendamentin e rrelatorit. Bëhet fjalë për komitetin shtetëror të diasporës, që drejtohet nga kryeministri dhe çdo institucion kërkon një nen të vetin". Në votimin e Kodit të Sjelljes së deputetëve pati edhe momente irritimi, siç ishte ai i deputetit Bashkim Fino me kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçit. Por edhe abstënimi i Finos, apo edhe largimi i ministrit të Diasporës, Pandeli Majko nuk e vunë në rrezik miratimin e ligjeve, që ishte gjithsesi një proces jo pa tension. Deputetja Mimi Kodheli i bëri thirrje qeverisë që jo vetëm të rishikojë tarifën e



VOTIMI
Pavarësisht petitionit të dërguar parlamentit nga një grup organizatash të Shoqërisë Civile, të cilat kishin mbështetur kandidaturën e Olimbi Hoxhajt për t'u votuar si komisionerja e re e Antidiskriminimit, mazhoranca e shpërfilli dje këtë kërkesë, duke votuar një kandidaturë tjetër. Robert Gajda do të jetë komisioneri i ri, duke zëvendësuar Irma Barakun. Gajda u betua dje në Kuvend.

PERPLASJA

Ministri i Diasporës, Pandeli Majko, kishte mbështetur propozimin e deputetit Adnor Shahmeti lidhur me një ndryshim në nenin 18 të ligjit, por ky ndryshim është kundërshtuar nga kolegët e Majkos, Taulant Balla dhe Mimi Kodheli, të cilët deklaruan se kërkesa për ndryshim nuk ishte paraqitur brenda afateve ligjore.



Kodi i sjelljes, Balla: Shqipëria s'meriton baltën me para ruse dhe tymin e gomave

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla reagoi dje pas miratimit në Kuvend të Kodit të Sjelljes së Deputetëve. Balla thekson se ky është një hap i rëndësishëm në rrugën e ndryshimit rrënjësor të funksionimit me rregulla dhe rritjes së transparencës së Kuvendit të Shqipërisë. "Një hap tjetër i rëndësishëm në rrugën e ndryshimit rrënjësor të funksionimit me rregulla dhe rritjes së transparencës së Kuvendit të Shqipërisë u hodh me miratimin Kodit të Sjelljes së Deputetëve. Prej ditës së parë kur kemi marrë këtë mandat qeverisë, e kemi thënë se tipari themelor i këtij mandati do të jetë besnikëria ndaj interesave të vendit dhe ndaj çdo njeriu të zakonshëm dhe çdo familje të zakonshme të këtij vendi. Jemi një parti besnike ndaj tyre. Një qeveri besnike ndaj tyre. Një grup parlamentar besnik ndaj tyre. Si kryetari i grupit parlamentar dua të falënderoj të gjithë deputetët tanë për angazhimin e tyre, por edhe për korrektesinë ndaj vendimmarrjes politike. Dua t'i falënderoj të gjithë deputetët tanë për gjakftohtësinë që tregojnë ndaj dhunës, provokimeve, gjuhës së rrugës nga opozita, halli i së cilës është drejtësia e re para së cilës do japin llogari dhe hetimi ndërkombëtar për lidhjet e Lulzim Bashës me fonde të dyshimta ruse", tha z.Balla.

Paloka: Skandaloze, e krahasoi popullin me organin gjenital

Thirrja e Ramës për "ngritje", byroja rrezon LSI, Hysi: Ishte poezi

Byroja parlamentare rrezoi mbrëmë kërkesën e LSI-së për përjashtimin e Edi Ramës nga seanca me 6 vota kundër dhe 3 pro. Sipas mazhorancës, nuk pati fjalë fyese nga ana e kryeministrit në seancën e javës së kaluar. Nëntë deputetë të LSI-së i kërkuan kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçit, përjashtimin e kryeministrit Rama nga Kuvendi për fjalorin e përdorur në seancën parlamentare të 29 marsit. Më konkretisht, në fjalën e tij gjatë zhvillimit të kësaj seance, kryeministri është shprehur: "Nuk mundni dot ju të bllokoni asgjë dhe të pengoni asgjë dhe për më tepër pastaj, jo po..., shiko këtu se do të ngrihen këta, do ngrihen



ata. Kjo e ngritjes është, 'thirri-thirri të të ngrihet, ai i shkreti kokulur s'të përgjigjet dot'. Por deputetja Vaslika Hysi habiti teksa tha se kjo ishte një poezi e thënë nga z.Rama. "Ai vetë thotë: 'jo ju lexoj një poezi'. Në gjuhën shqipe disa fjalë mund të marrin dy kuptime. Kolegët e opozitës nuk bënë asnjë

kërkesë për 7 ditë, ndaj kjo ishte një lëvizje tjetër e opozitës", tha Hysi. Nënkrjetari i Kuvendit, deputeti demokrat Edi Paloka e quajti rastin më skandaloz mospërjashtimin e kryeministrit Edi Rama nga byroja, duke rrezuar kështu kërkesën e LSI-së. Paloka tha se nuk ka ndodhur kurrë që një kryeministër të quajë organ gjenital popullin e tij, por sipas tij, mazhoranca përdori të gjitha argumentet absurde për ta bërë opozitën të rregullores së Kuvendit me 10 ditë nga seanca plenare, por për PS nuk ka pasur fjalë fyese.

Rrugës së Kombit në favor të kuksianëve, por edhe të investojë në rrugën e vjetër të Kukësit. Deputetja e PS për qarkun e Kukësit tha në Kuvend se hapja e rrugës do të jetë një alternativë për banorët. Ajo gjithashtu kërkoi që qeveria të bëjë transparente shpërndarjen e të ardhurave që vijnë nga taksa e qarkullimit. "Fort të nderuar kuksianë, hasianë, tropanjë kam folur duke ju parë në sy e po në sy ju shikoj edhe sot, e flas me ju e zemërën e një nëne dhe fuqinë e mendjes së një ligjëvëniesie. Unë jam për shtetin e së drejtës, jam për ligjin,

për ekonominë e tregut, por jam edhe për një rishpërndarje më të drejtë e më të moralshme që favorizon të dobët dhe të varfrit dhe jam për më shumë transparencë e më pak demagogji. Ndaj i kërkoi qeverisë përpara se të rishikojë tarifën e mirëmbajtjes në favor të banorëve të qarkut të Kukësit, të përkujdeset dhe të investojë rrugën e vjetër të Kukësit, si një alternativë për banorët atje, të shikojë dhe të rikategorizojë të gjitha rrugët në vend dhe në këtë mënyrë ta thjeshtojë dhe diferencojë sistemin e taksimit. Të bëjë transpar-

ente, ku dhe si shpërndahen të ardhurat që vijnë nga taksa e qarkullimit, të vlerësojë pozitivisht të gjitha propozimet që ka bërë dje Komisioni i Ekonomisë", theksoi zj.Kodheli. Në seancën e djeshme plenare të zhvilluar pa praninë e opozitës, që ndodhej në protestë, Kuvendi miratoi Kodin e Sjelljes së Deputetëve. Ky Kod u miratua me 74 votat e shumicës dhe nuk pati asnjë votë abstenim apo kundër. Kodi ka marrë 74 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Votave të Partisë Socialiste iu bashkuan edhe ato të PDIU-së.

Tregtarët: Po shkojmë drejt falimentit, përgjysmoni Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Bizneset e vogla ulin qepenat, nuk përballojnë dot taksat

Përfshirja në skemën e TVSH-së rrit kostot

Përfshirja në skemën e TVSH-së të 11.500 bizneseve të vogla me xhiro vjetore mbi 2 milionë lekë në vit ka sjellë reagimin e biznesit, kësaj here me protesta. Biznesi i vogël të tregu i "Qytetit të Nxënë-sve" në Tiranë uili qepenat në shenjë proteste për përfshirjen në skemën e TVSH. Për 2 orë ata bllokuan shitjet, atmosfera është e zymtë dhe tregtarët e vegjël janë të frikësuar të flasin, pasi në derë u trokasën menjëherë tatimet. Ndërkohë, shoqata e biznesit të vogël thotë se tregtarët e kanë të pamundur të mbijetojnë. "Nuk themi që nuk paguajmë taksat, por brenda normave dhe mundësive që ka biznesi. Sot biznesi është në pikë të hallit. Që të futet në TVSH do kërkojë një ekonomist, ai do të kërkojë 100 mijë lekë në muaj. Biznesi sot e ka të pamundur për t'i përballuar këto", shprehet Besnik Muçaj, nënkryetar i Sho-



qatës së Biznesit të Vogël. Barra fiskale është rritur sipas biznesit të vogël, ndërkohë që rritja e pragut të TVSH duhet të ishte drejtimi i duhur. "Ne do vazhdojmë, nëse qeveria çështjen e TVSH-së nuk e rishikon. Ne kemi kërkuar që ngritja e pragut të jetë 100 milionë të vjetra, pragu ku të klasifikohet biznesi i vogël me biznesin e madh", thotë ai. Nga 1 prilli pragu për përf-

shirjen e biznesit në skemën e TVSH ka zbritur nga 5 në 2 milionë lekë xhiro vjetore. Sipas të dhënave zyrtare, automatikisht në këtë skemë janë futur 11.500 subjekte.

PROTESTAT NË RRETHE

Në qytetet e Korçës dhe Fierit bizneset e vogla kanë mbyllur aktivitetin për dy orë. Bizneset janë hedhur në protestë kundër ven-

dosjes së TVSH-së. Mësohet se tregtarët e Pazarit të Korçës kanë pezulluar aktivitetin prej orës 10:00 deri në mesditë. Ata kërkojnë rishikimin e vlerës së TVSH-së. "TVSH e papërbalueshme, po shkojmë drejt falimentimit. Kërkojmë përgjysmim të vlerës së TVSH-së deri në 1 milion lekë. Nuk mund të rritim çmimet, sepse fuqia blerëse e konsumatorëve është e ulët. Kërkojmë që TVSH-ja për produktet e shportës të shkojë 6%. Do përkallëzime protestat deri në regjimin e qeverise. Protesta do vijojë deri në mesditë", thonë tregtarët. Ndërsa në Fier, rreth 100 biznese në qytet kanë ulur qepenat duke kundërshtuar në këtë mënyrë TVSH-në për biznesin e vogël. "Në këtë mënyrë nuk bashkohen me asnjë nismë kombëtare apo politike, por janë të detyruar ta bëjnë, pasi nuk paguajnë dot taksat, bazuar kjo në xhiron e ulët që bëjnë".

PESË POROSITË

- Tatimet përfshijnë automatikisht në skemë bizneset**
Çdo tatimpagues që kryen furnizim mallrash ose shërbimesh, i cili për vitin kalendarik 2017 ka realizuar një qarkullim nga 2.000.000-5.000.000 lekë, është regjistruar automatikisht nga administrata tatimore në skemën e TVSH-së.
- Këta tatimpagues, duhet të kenë**
1- Ndryshimin e shkallës tatimore duke vendosur shkallën 20% apo shkallët e reduktuara sipas fushës së veprimtarisë së tatimpaguesve.
2- Të gjithë tatimpaguesit që janë përfshirë në skemën e TVSH-së kanë të drejtë, që në periudhën e parë tatimore (prill 2018), të njohin TVSH-në e zbritshme për mallrat e inventarit gjendje në datën 31 mars 2018, mallra këto me qëllim për t'u shitur, për të cilat do të llogarisë TVSH-në në shifje.
- Kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar këtë të drejtë janë si më poshtë:**
■ Mallrat do të shërbejnë për kryerjen e furnizimeve të tatueshme që kanë të drejtën e zbritjes.
■ Të kenë evidencuar listën e mallrave stok (inventarin) të specifikuar në sasi dhe në vlerë. Një kopje e inventarit duhet të dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore dhe të ngarkohet në "e-Filing", të rubrika "Gjishëje të mia", brenda datës 30 prill 2018. Ky inventar duhet të jetë i evidencuar në regjistrat dhe kontabilitetin e personit të tatueshëm.
■ Çdo mall i përfshirë në inventar duhet të jetë i justifikuar me faturat tatimore të blerjes me TVSH dhe i blerë jo më parë se 12 periudha tatimore.
■ Të pajiset me blloqe të faturave tatimore pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku janë të regjistruar, për rastet kur do të kryejë transakcione me vlerë mbi 40.000 lekë dhe/ose nën këtë vlerë kur e kërkon blerësi. Të lëshojnë kuponin tatimor për çdo shitje për klientat konsumatorë final.
■ Të regjistrojë në mënyrë kronologjike faturat e shitjes dhe të blerjes në format elektronik, në librat mujorë të shitjes dhe blerjes. Afati i parë i këtij deklarimi është data 10 korrik 2018 për periudhat tatimore prill-maj-qershor 2018.
■ Të dorëzojë deklaratën e TVSH-së, bazuar në të dhënat e librave të shitjes dhe të blerjes, e cila përpiqet me bazë mujore dhe dorëzohet elektronikisht brenda datës 14 të muajit pasardhës të tremujorit përkatës. Afati i parë i këtij deklarimi është data 14 korrik 2018, për periudhat prill-maj-qershor 2018.

REAGIMET

Shoqata e Biznesit të Vogël kishte paralajmëruar që në mars se do të organizonin protesta kundër vendimit për uljen e pragut të TVSH-së. Sipas tyre, vendosja e TVSH-së për biznesin e vogël rrit shpenzimet e njësive ekonomike, por edhe çmimet e produkteve dhe shërbimeve. Sipas Shoqatës së Biznesit të Vogël, rritja e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve që ata tregtojnë do

të përkthehet në falimentim të menjëhershëm, duke qenë se fuqia blerëse është e ulët. Tatimet parashikojnë që fillimisht në skemë do të përfshihen rreth 11.500 biznese të vogla, por sipas përfaqësuesve të shoqatës, në rast se tatimet do të monitorojnë bizneset, të gjithë përfshihen në skemë dhe e kalojnë pragun prej 2 milionë lekësh, i cili sipas tyre është lehtësisht i kapërcyeshëm prej bizneseve të vogla.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSTITUCIONI I KOMISIONERIT PUBLIK

NJOFTIM

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të institucioni i Komisionerëve Publikë", shpall vendet vakante për pozicionet:

DREJTOR NË DREJTORINË E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN (paga II-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të ketë diplomë të nivelit "Master i shkencave" në Shkenca Ekonomike.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në nivel drejtues e menaxherial.

SPECIALIST SEKRETARIE (paga IV-a) 2 pozicione

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Diplomë të nivelit Bachelor në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë vite përvojë në profesionin e sekretares gjyqësore.

SPECIALIST REDAKTOR GJUHËSOR (paga IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Diplomë të nivelit "Master" në Gjuhë Letërsi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e zbardhjes, draftimit, redaktimit etj. të dokumentave.

PËRKTHYES (paga II-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit master shkencor në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip-anglisht-shqip.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare. Preferohen kandidatuarat e licencuara përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

KOORDINATOR PËR MEDIAN DHE MARRËDHËNIET ME JASHTË (paga III-a)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Diplomë të nivelit "Master" në Drejtësi/Gazetari/Gjuhë-Letërsi etj.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e gazetarisë, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënitë ndërkombëtare etj.

SPECIALIST PRITJE ME POPULLIN (paga IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Diplomë të nivelit "Master" në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e marrëdhënieve me publikun, administratë publike, etj.

DREJTOR NË DREJTORINË EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (paga II-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Diplomë të nivelit "Master i shkencave" në Shkenca Ekonomike.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në nivel drejtues e menaxherial.

SPECIALIST IT (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatikë, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (WordPress, Drupal, Joomla etj.).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

SPECIALIST FINANCË/BUXHETI (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master shkencor" në Shkenca Ekonomike, dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare, si: Alpha/Financa 5 etj.

SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master shkencor"
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 4 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 16 deri 20 Prill 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucioni të Komisionerëve Publikë, në adresën: Godina e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë institucioni të Komisionerëve Publikë në adresën: Godina e ish Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 20.04.2018 dhe të vërtetohet me fletë-mandati i lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidatit përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidatit dorëzohen të mbyllura në zarf, 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jëteshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti)
- Dokumentat (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetedeklarim, certifikata, trajnime etj) fotokopje ose të notorizuara. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (Vërtetim nga Gjykata, Vërtetim nga Prokuroria, Dëshmi e gjendjes gjyqësore)
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Një rekomandim nga punëdhënësi;
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë deponuar dokumenta të fotokopjuara, përpara intervistës i parashirojnë Komitetit ad-hoc dokumentat e njësura ose ato origjinale.

Policia e Tiranës në bashkëpunim me Interpol Tiranë ka vënë në pranga ditën e djeshme 43-vjeçarën, Manjola Prifti, banuese në Tiranë. Arrestimi i Priftit u bë me qëllim ekstradimit në Itali, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar për trafik të lëndëve narkotike. Autoritetet italiane e kanë dënuar 43-vjeçarën me 7 vjet, 3 muaj dhe 15 ditë burg, për veprën penale "Pjesëmarrje në organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike". Manjola Prifti është një personazh jo pak i njohur, pasi ka qenë bashkëshortja e Mirit të Xhikës (Fatmir Rama), një prej kokave të trafikut të dro-

M. Prifti: Ndalimi im i hapi rrugë vjedhjes së pronave që trashëgojnë im bir

Akuzohet për trafik droge në Itali, policia e Tiranës arreston ish-bashkëshorten e Mirit të Xhikës

AKUZA

Autoritetet italiane e kanë dënuar 43-vjeçarën Manjola Priftin, me 7 vjet, 3 muaj dhe 15 ditë burg, për veprën penale "Pjesëmarrje në organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike".

gave të forta nga Shqipëria në drejtim të vendeve të BE. Miri i Xhikes është vrarë në Tiranë 15 vjet më parë, nga një atentat në ambientet e "Kartodromit", biznesit në

pronësi të tij në Lundër. Sipas autoriteteve italiane Fatmir Rama e kryente aktivitetin e paligjshëm në bashkëpunim me bashkëshorten Manjola. Pas

vrasjes së Mirit të Xhikes, e gjithë pasuria kapitale dhe monetare, i kaloi bashkëshortes së tij. Në vitin 2012 ajo u arrestua për probleme ligjore në Itali, por më pas u la e lirë. Më herët Manjola është shprehur se ndalimi i saj i hapi rrugë vjedhjes së pronave që trashëgojnë Endi Rama, djali i Fatmir Ramës, që vlejnë miliona USD dhe ndodhen në zonat e preferuara për ndërtime. Në një memo drejtuar në atë kohë



43-vjeçarja, Manjola Prifti

ambasadorit amerikan, ministrit të Drejtësisë dhe Prokurores së Përgjithshme, Manjola Prifti pohoi se është arrestuar vetëm me një letër, që shkel në mënyrë

arbitrar konventën europiane për ekstradim dhe dispozitat e K.Pr.Penale dhe "e gjitha që të heqë dorë nga prona që trashëgojnë djali im i mitur".

Bregdeti i Spillesë, Inspektorati: Jemi të vendosur për të denoncuar abuzuesit në të gjithë Shqipërinë

Ndërtimet pa leje, IKMT kallëzon kryebashkiakun e Rogozhinës

Beqir Nuredini: Mund të hapin 200 çështje për këtë histori, unë kam zbatuar ligjin

Ina Allkanjari

Pas hetimit të nisur nga prokuroria ndaj kryetarit të Bashkisë së Rogozhinës, Beqir Nuredinit, për abuzimet me pronat në Spille, ky i fundit është njohur ditën e djeshme me një kallëzim penal të ngritur ndaj tij nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit. Duke e akuzuar për "shpërdorim detyrë" IKMT njoftoi se kallëzimi penal ndaj Nuredinit u depozitua pasi me veprimet dhe mosveprimet e tij ka lejuar ndërtimin e 31 objekteve në zonën bregdetare të Spillesë. "Jemi të vendosur për të zbatuar ligjin dhe denoncuar abuzuesit në të gjithë Shqipërinë. Prioritet janë zonat bregdetare, turistike dhe ato të mbrojtura me ligj"- thuhet në njoftimin e IKMT. Ndërkohë në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", kryetari i Bashkisë së Rogozhinës mohoi akuzat e ngritura ndaj tij duke u shprehur se është i gatshëm ndaj çdo hetimi. "Për të njëjtën akuzë kam një çështje të hapur nga prokuroria e Kavajës. Është turp i madh, nuk ia vlen të bëj një replikë. Mund të hapin 200 çështje për këtë histori, kam zbatuar procedurën që parashikon ligji, besoj se e kam bërë shumë mirë punën time. Gjithsesi mbetem i hapur për çdo hetim. Falë ndërhyrjeve të bëra nga Bashkia Rogozhinë, plazhi i Spillesë është kthyer në një ndër destinacionet më të rëndësishme turistike në vend", shprehet Beqir Nuredini. Kujtojmë se në

muajin shkurt 2018, prokuroria nisi hetimin për abuzimet me pronat në Spille, ku të dyshuar si persona të përfshirë janë disa zyrtarë të Bashkisë, përfshirë edhe kryebashkiaku. Në lidhje me këtë hetim të muajit shkurt, Beqir Nuredinit i është ndaluar nga gjykata të dalë jashtë vendit. Sipas prokurorisë në bazë të hetimit proaktiv rreth 1 vjeçar, ka rezultuar se këta zyrtarë në bashkëpunim me njeri-tjetrin, duke abuzuar me detyrën kanë falsifikuar dokumentet, duke bërë ndryshim e zërit kadastral për një sipërfaqe prej 11.000 m2 tokë në vijën bregdetare të Spille Kavajë dhe në fshatrat përreth, duke e tjetërsuar nga "Tokë pa fruta" në tokë "Are" dhe më pas kanë bërë ndarjen në mënyrë të kundërligjshme të kësaj sipërfaqe toke, në interes të tyre dhe personave të tjerë. Më herët, pas marrjes në pyetje nga prokuroria e Kavajës, Nuredini është shprehur se nga hetimet e organit të akuzës është njohur me disa dokumente, të cilat ishin të falsifikuara. "Për këto falsifikime unë kam bërë denoncim në organet përkatëse. Masa 'Detyrim Paraqitje', e caktuar nga gjykata, për mua ishte e papritur. Kjo për shkak se unë kam qenë gjithmonë i gatshëm gjatë hetimeve dhe kam vënë në dispozicion të prokurorisë çdo dokument dhe dëshmi që më është kërkuar. Gjithsesi mbetem i hapur për çdo hetim", është shprehur më herët kryetari i Bashkisë së Rogozhinës.



Kryetari i Bashkisë së Rogozhinës, Beqir Nuredini

NUREDINI

"Për të njëjtën akuzë kam një çështje të hapur nga prokuroria e Kavajës. Është turp i madh, nuk ia vlen të bëj një replikë. Mund të hapin 200 çështje për këtë histori, kam zbatuar procedurën që parashikon ligji, besoj se e kam bërë shumë mirë punën time. Gjithsesi mbetem i hapur për çdo hetim", - shprehet Beqir Nuredini.

"Pasuritë e mia janë tërësisht të ligjshme"

Ish-kryeprokurori Lalla mohon akuzat: Nuk kam asgjë për t'u frikësuar



Ish-Prokurori i Përgjithshëm, Adriatik Lalla

“

ADRIATIK LLALLA

"Pasuritë e mia janë tërësisht të ligjshme, të deklaruara në institucionet përkatëse, për të cilat janë paguar edhe taksat përkatëse. Nuk shoh asnjë problematikë në këtë drejtim. Nuk ka asgjë për të cilën unë të jem i shqetësuar apo dhe i frikësuar", - shprehet Lalla.

ankimua në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik. Pritet që për këtë çështje të zhvillohet një seancë gjyqësore. Gjithashtu, hetimit ndaj ish-drejtuessit të akuzës vjen pas ndalimit të hyrjes së Adriatik Lallës në SHBA nga Departamenti i Shtetit me argumentin se ishte i përfshirë në korrupsion.

Ish-Prokurori i Përgjithshëm, i cili po hetohet që prej 15 marsit të këtij viti nga prokuroria e Durrësit për veprat penale të shpërdorimit të detyrës, deklarimit të rremë të pasurisë dhe mosdeklarimit të parave në kufi, ka mohuar akuzat e ngritura ndaj tij. Në një intervistë për agjencinë BIRN, Adriatik Lalla sqaron se pasuritë e tij janë të ligjshme dhe se nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. "Pasuritë e mia janë tërësisht të ligjshme, të deklaruara në institucionet përkatëse, për të cilat janë paguar edhe taksat përkatëse. Nuk shoh asnjë problematikë në këtë drejtim. Nuk ka asgjë për të cilën unë të jem i shqetësuar apo dhe i frikësuar", -shprehet Lla-

lla. Hetimet për ish-kryeprokurorin filluan pasi ai hoqi dorë nga e drejta e tij për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë. Në këtë mënyrë Lallës u ndërpre procesi i vetingut nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Por ky vendimin u

Shitje me Ankand te pare nga Studio Permbarimore L.D.C
 - Apartment" me nr. pasurie 1/1309+1-19, vol. 37, faqe 217, ZK. 8532, regjistruar ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Fier. Me çmim shitje 36.000 Euro
 Data e shpalljes 15.03.2018
 Data e zhvillimit 11.04.2018 deri ne oren 16.00
 Ankandi zhvillohet ne ambientet e zyles Studio Permbarimore L.D.C te ndodhur ne adresen: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8/1, Kati 1, Tirane, e-mail: erjon.papalazo@yahoo.com.

Banorët: Jemi terrorizuar nga ajo që ndodhi, Ademi nuk është person problematik

Brika Meta

GJIROKASTËR

T ronditet Lazarati. Banesa e një prej të dënuarve për vrasjen e efektivit të RENEA-s, Ibrahim Basha u sulmua me tritol në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Bëhet fjalë për shtëpinë e Klodian Selimit, i dënuar me 13 vjet burg. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 02:30. Mësohet se lënda plasëse ishte vendosur në derën e jashtme të banesës së Adem Selimit, babait të Klodianit. Fatmirësisht nga shpërthimi i eksplozivit janë shënuar vetëm dëme materiale dhe nuk ka pasur persona të lënduar. Menjëherë blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit.

NGJARJA

Adem Selimi dhe pjesëtarët e familjes së tij (bashkëshortja, djali dhe nusja) ishin në gjumë kur kanë dëgjuar një zhurmë të tmerrshme. Të terrorizuar ata kanë shpejtuar të dalin jashtë, kur kanë parë se kati i parë i banesës 2 katësh kish të pësuar dëme të shumta materiale. Menjëherë është sinjalizuar policia, e cila ka shkuar në vendngjarje dhe ka kryer veprimet e para hetimore. Më pas blutë kanë shoqëruar dhe marrë në py-

Lazarat, tritol banesës së të dënuarit për vrasjen e efektivit të RENEA-s

Adem Selimi: U terrorizuar, s'kam konflikte me askënd



Efektiv i RENEA-s, Ibrahim Basha



Klodian Selimi në sallën e gjyqit

etje të zotit e banesës, njëherësh edhe shënjestër e atentatit. Ai ka deklaruar se nuk ka konflikte me askënd dhe se nuk e di motivin e këtij sulmi. Burimet e mësipërme pohuan se Adem Selimi nuk është person i skeduar, me të kaluar të dyshimtë apo me precedent penal. Ai njihet si person i qetë dhe pa probleme në Lazarat. Ndërkaq, sulmi

me tritol ka shkaktuar panik tek banorët e fshatit Lazarat. "Jemi terrorizuar nga ajo që ndodhi. Ademi merret me bujqësi dhe blegtori. Ai është person jo problematik dhe shikon punën e tij. Nuk e dimë se kush i vuri tritol banesës së tij", -thante disa banorë të Lazaratit.

HETIMET

Burime pranë grupit hetimor

pohuan se shënjestra e sulmit, ishte banesa e Adem Selimit. Ky i fundit është babai i Klodian Selimit, një nga personat e dënuar me 13 vite burg për vrasjen e efektivit të RENEA-s Ibrahim Basha. Klodian Selimi ka qenë pjesë e grupit të zjarrit në Lazarat, që vranë efektivin Ibrahim Basha afro tre vite më parë. I riu bashkëpunoi me

prokurorinë për zbardhjen e ngjarjes ku humbi jetën oficeri i RENEA-s, ndaj dhe dyshohet që ky të ketë qenë dhe shkaku i vënies së tritolit në shtëpinë e familjes së Klodian Selimit. Ngjarja në fjalë ndodhi më 24 qershor të vitit 2015 në Lazarat ku gjatë shkëmbimit të zjarrit me grupin të zjarrit dhe policisë mbeti i vrarë efektiv Basha.



Turistët anglezë: Si u bllokua nga bora për 3 orë në Theth

SHKODËR - Kanë ardhur nga Mançesteri për të kaluar pak ditë në Theth të Dukagjinit në Shkodër, por janë bllokuar nga bora. Për tri orë me radhë dy turistët anglezë kanë qëndruar të frikësuar mes maleve dhe me të ftohtit. Ata kanë udhëtuar nga Anglia në Malin e Zi dhe nga aty drejt Shkodrës për të eksploruar Thethin. Çifti anglez ka mundur që të shkojë deri në Okol të Bogës, pjesë e Malësisë së Madhe dhe aty makina e tyre është bllokuar për shkak të trashësisë së borës, që shkon deri mbi 50 cm. Të gjendur në një situatë të tillë, ata kanë njoftuar faqen e "booking", ku kishin pronuarur në Amerikë. Faqja e "booking" ka lajmëruar një grua në Theth, në shtëpinë e të cilës do shkonin dy turistët. Të vetmit që u kanë shkuar në ndihmë janë Agim Dardha, drejtor i Zonave të Mbrojtura në Shkodër dhe Edmond Tërthorja, kryeinspektor i Mjedisit. Dy zyrtarët janë nisur nga Shkodra dhe pas një ore rrugë kanë parë turistët e bllokuar. Përmes mjeteve rrethanore dhe duke shtyrë makinën e dy turistëve është arritur që të zhbllokohen. Ndërkaq, Deny Pief tregoi dje për "GSH" momentet e vështira. "Ne provuan që të shkonim drejt Thethit për të gjetur ndonjë shtëpi pushimi, por u bllokua këtu nga bora. Atëherë lajmëruam në Amerikë në "booking", aty nga ku kishim kërkuar më përpara për të shkuar drejt Thethit. Ne nuk e dimë se rruga këtu ishte e bllokuar nga bora, pasi nuk do të kishim ardhur. Kemi pritur gjatë dhe s'po na vinte askush në ndihmë. Për tri orë kemi qëndruar shumë të frikësuar mes maleve dhe po ashtu kemi pasur shumë ftohtë. Është e vështirë, sepse s'mund ta linim makinën ndezur gjithë natën për të bërë ngrohtë, sepse do na mbaronte karburanti dhe do kishim qëndruar shumë orë në të ftohtë. U gjendëm në rrezik. Është hera e parë në Shqipëri dhe na u desh të përballemi me këtë situatë", tha Deny Pief. Ndërsa, Alis Pief u shpreh: "Fasi u bllokua, provuan që të ecim në këmbë për të gjetur ndonjë njeri, por nuk pamë askënd. Nuk na besohet se tani kemi njerëz përballë. Megjithatë, frika mbaroi tani dhe jemi të lumtur". Dy turistët anglezë duke mos pasur mundësinë që të përfundojnë udhëtimin e tyre drejt fshatit turistik të Thethit, janë kthyer mbrapsht drejt Shkodrës për të kaluar natën, ndërsa të zhgënjyer do rikthehen sërish në shtetin e tyre, në Angli.

Rrihet barbarisht dhe biznesmeni Aleksandros Stamatiadis

Grabitet banesa e këngëtarit Lefteris Pantazis, mediat greke: Autorët dyshohen të jenë shqiptarë

GREQI - Rrahja brutalisht e biznesmenit grek Aleksandros Stamatiadis nga dy grabitës që ishin futur në shtëpinë e tij në Athinë ka ngritur policinë në këmbë. 52-vjeçari kaloi në gjendje kritike për jetën, pasi u godit nga dy grabitësit me shufër hekur. Dy ditë më parë ai kishte ndërjerë grabitësit që ishin futur në shtëpi, ndërsa familja e tij ishte në gjumë. Mjekët në spitalin "Georgios Gennimatas" të Athinës kryen të paktën dy operacione, ndërsa 52-vjeçari kishte goditje të shumta në kokë dhe disa organe. Autoritetet greke e lidhin sulmin e biznesmenit edhe me grabitjen që ndodhi në banesën e këngëtarit të njohur Lefteris Pantazis. Ky i fundit, ndonëse është nga këngëtarët e preferuar grekë për shqiptarët, duket se kjo gjë nuk ka arritur ta heqë nga shënjestra e grabitësve, po shqiptarë. Banesa e këngëtarit të njohur Lefteris Pantazis në Vouliagmeni është grabitur mbrëmjen e së shënës nga dy persona, të dyshuar si shqiptarë, të cilët dyshohet se janë autorë edhe të grabitjes së banesës së biznesmenit Aleksandros Stamatiadis, i cili mbeti i plagosur rëndë. Lefteris



Këngëtarit Lefteris Pantazis

Pantazis është i njohur në Shqipëri për shkak edhe të bashkëpunimit me këngëtarin Devis Xherahu. Mediat greke shkruajnë se dy persona të maskuar hynë në shtëpinë e Pantazis dhe kërcënuan punonjësit rusë duke iu marrë 1000 euro, ora dhe bizhuteri me vlerë. Duke folur për mediat, këngëtarit tha se vjedhja ndodhi edhe

pse shtëpia e tij ishte 50 metra larg nga stacioni i policisë Vouliagmeni. Lefteris Pantazis tregoi se punëtorët kishin qenë në gjumë dhe hajdutët ishin futur nga kuzhina, pasi dera nuk ishte e mbyllur mirë dhe alarmi nuk kishte funksionuar. "Vazat flinin, ata mbanin armë në duar dhe morën 1.000 euro, por fatmirësisht vazjat



Shtëpia e biznesmenit grek Aleksandros Stamatiadis

janë mirë", tha këngëtarit. Vetë Pantazis nuk ishte në shtëpi, pasi ndodhej në Larisa për punë. Deri tani, nga laboratorët e mjekësisë ligjore nuk është marrë ndonjë provë që do hidhte dritë mbi hetimet, ndërsa nga ajo që kanë thënë në një fazë të parë dëshmitarët okularë nuk jepën shumë të dhëna për profilin e autorëve. "Me të

dhënat e deritanishme, dyshohet se autorët janë të huaj, sipas të gjitha gjasave shqiptarë dhe i kanë zgjedhur rastësisht objektivat e tyre", shkruan "Prothothema", e cila thotë se policia e lidh grabitjen e Lefteris me rrahjen e një biznesmeni. Sipas policisë, autorët kishin veshur doreza dhe kapuç, që u mbulonin plotësisht fytyrat.

KUKËS - Krimi në familje ka tronditur banorët e Kukësit. Një 76-vjeçar ka masakruar bashkëshorten me sëpatë dhe më pas është larguar nga banesa. Burime zyrtare nga policia e qytetit verilindor dje bënë me dije se ngjarja e rëndë ka ndodhur rreth orës 23:16 të së mërkurës në fshatin Borje të këtij rrethi.



Masakroi bashkëshorten me sëpatë, shpallet në kërkim 76-vjeçari Adem Tale, baba i 6 fëmijëve

Mësohet se autori i krimit është Adem Tale, baba i gjashtë fëmijëve. Pas sinjalizimit për vrasjen e 68-vjeçares me inicialet Z.T., blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Paraprakisht dysho-

het se i moshuari e ka goditur për vdekje të shoqen pas një konflikti për motive të dobëta. Ndërkaq, policia ka bërë krehjen e gjithë zonës me qëllim kapjen e autorit, ndërsa po heton intensivisht për zbardhjen e

plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje, e cila është e veshur me mister. Materialet në ngarkim të 76-vjeçarit pritet që t'i kalojnë prokurorisë së Kukësit për hetime të mëtejshme.

Dyshime për arrest kardiak, prindërit: Djali nuk ka pasur probleme shëndetësore

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Një fëmijë 3-vjeçar nga Durrësi ka humbur jetën mesditën e djeshme. Mësohet se vogëlushi ka qenë në një kopsht privat në lagjen nr.4 të qytetit bregdetar dhe nuk është ndër mirë (ka pasur të vjella). Menjëherë ai është dërguar në Poliklinikën e Specialiteteve në Durrës dhe nga aty në urgjencën se Pediatrisë, por nuk ka mundur të mbijetojë. Pas ngjarjes së rëndë, familjarët pohuan se djali nuk ka pasur probleme shëndetësore dhe ka qenë i shëndetshëm. Nga ana tjetër, edukatorët u shprehën se fëmija pasi është zgjuar nga gjumi, ka ngrënë drekë (supë) dhe më pas i filluan të vjellat. Ndërkohë, nëndrejtori i Spitalit Rajonal të Durrësit, Genti Kavaja deklaroi se 3-vjeçari ka mbërritur në poliklinikë pa puls dhe pa tension dhe se ai humbi jetën teksa po transportohej me ambulancë për në spital. Gjithsesi, mjeku Kavaja tha se s'mund të thuhet asgjë deri në fund të hetimeve. Mësohet se konkluzionet e sakta për shkakun e vdekjes së fëmijës do të dalin pas dy javësh, bazuar në përgjigjen e analizave. Ndërsa, paraprakisht dyshohet që shkak i vdekjes së 3-vjeçarit të ketë qenë arresti kardiak (vdekje e bardhë).

NGJARJA

"Më datë 05.04.2018, rreth orës 13:15, në lagjen nr.4 Durrës, nga një kopsht privat është dërguar në Spitalin Rajonal Durrës në gjendje të rëndë ku ka ndërruar jetë fëmija me inicialet D.Z. 3 vjeç. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor po punojnë për sqarimin e rrethanave të ngjarjes", thuhej në njoftimin zyrtar të policisë së Durrësit. Ndërkaq, burime nga kopshti nr.4 u shprehën se fëmija u bë keq krejt papritur. "Djali ishte në gjumë dhe kur u ngriti hëngri drekë. Më pas ai u ul në karrigen e tij. Pas pak minutash fëmija ra dhe u nxi nga mesi e sipër dhe në fytyrë. Menjëherë i është dhënë ndihma e parë mjekësore, i është bërë masazh zemre dhe frymëmarrje artificiale. Kur pamë se gjendja e tij shëndetësore po rëndohej, e dërguam në krahë tek poliklinika e specialiteteve, e cila

U sëmur në kopsht, 3-vjeçari ndërron jetë gjatë rrugës për në spital

Mjeku Genti Kavaja: Fëmija vdiq në ambulancë, ishte pa puls dhe pa tension

EDUKATORET

"Djali ishte në gjumë dhe kur u ngriti, hëngri drekë. Më pas ai u ul në karrigen e tij. Pas pak minutash fëmija ra dhe u nxi nga mesi e sipër dhe në fytyrë. Menjëherë i është dhënë ndihma e parë mjekësore, i është bërë masazh zemre dhe frymëmarrje artificiale. Kur pamë se gjendja e tij shëndetësore po rëndohej, e dërguam në krahë tek poliklinika e specialiteteve", thanë burime nga kopshti nr.4 në qytetin e Durrësit.



Nëndrejtori i Spitalit Rajonal të Durrësit, Genti Kavaja

DYSHIMI

Nëndrejtori i Spitalit të Durrësit, Genti Kavaja deklaroi se 3-vjeçari ka mbërritur në poliklinikë pa puls dhe pa tension dhe se ai humbi jetën teksa po transportohej me ambulancë për në spital. Mësohet se konkluzionet e sakta për shkakun e vdekjes së fëmijës do të dalin pas dy javësh, bazuar në përgjigjen e analizave. Ndërsa, paraprakisht dyshohet që shkak i vdekjes së 3-vjeçarit të ketë qenë arresti kardiak (vdekje e bardhë).

ndodhet afër kopshtit", pohuan burimet nga ky institucion arsimor. Ndërsa, burime nga poliklinika deklaruan se fëmija ka mbërritur në gjendje shumë të rëndë, pa puls dhe tension. Pas ngjarjes së rëndë, policia e Durrësit ka nisur hetimet. Blutë kanë marrë në pyetje bashkëshortët Zeka, të cilët janë tronditur nga humbja e djalit të tyre të vetëm. E pyetur nëse fëmijës i kanë bërë vizitë për zemrën, nëna e 3-vjeçarit është përgjigjur: "Djali nuk ka pasur probleme shëndetësore. Nuk i kam bërë vizitë për zemrën. Ai ishte mirë kur e dërguam në kopsht". Ndërkaq, burime zyrtare nga spitali i Durrësit bënë me dije se fëmijës i është bërë autopsia. Personeli mjek-

o-ligjor në bashkëpunim me grupin e mjekëve specialistë të ngritur për të zbuluar shkakun e vdekjes nuk kanë dalë në një konkluzion. Ata kanë marrë mostra, të cilat do të dërgohen në laboratorin toksikologjik në Tiranë dhe pas dy javësh do të dalin përgjigjet e analizave.

NËNDEJTORI I SPITALIT

Në lidhje me ngjarjen e rëndë ka reaguuar nëndrejtori i Spitalit Rajonal të Durrësit, Genti Kavaja. "Si pas informacioneve paraprake, fëmija ka mbërritur në qendrën shëndetësore të mjekëve pediatër në gjendje tejet të rëndë, pa puls dhe pa tension. Kanë bërë veprimet e para. Mjekët kardilogë janë gjendur men-

PRINDËRIT E 3-VJEÇARIT

Pas ngjarjes së rëndë, policia e Durrësit ka nisur hetimet. Blutë kanë marrë në pyetje bashkëshortët Zeka, të cilët janë tronditur nga humbja e djalit të tyre të vetëm. E pyetur nëse fëmijës i kanë bërë vizitë për zemrën, nëna e 3-vjeçarit është përgjigjur: "Djali nuk ka pasur probleme shëndetësore. Nuk i kam bërë vizitë për zemrën. Ai ishte mirë kur e dërguam në kopsht".

jëherë në poliklinikë dhe kanë bërë edhe ata veprimet e para dhe ndërkohë, në moment është njoftuar urgjencia e spitalit. Ambulanca ka mbërritur në vendngjarje në


kohë rekord (për 3 minuta) ka marrë fëmijën që ka qenë në gjendje tejet të rëndë. Ai ka ndërruar jetë gjatë rrugës për në spital", u shpreh mjeku Kavaja.

FUSHË KRUIJË

Dy vëllezër janë plagosur me mjete të forta në Fushë-Krujë, pas një konflikti mes tyre. Burime nga policia lokale bënë me dije se konflikti mes dy vëllezërve ka nisur për motive pronësie. Të plagosurit janë E.C. 17 vjeç dhe B.C. 25 vjeç, të cilët janë transportuar në Tiranë. Policia në vendngjarje ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të sh-

Konflikti për pronën, dy vëllezër përleshën dhe plagosen me leva

kaqeve dhe rrethanave. "Më datë 05.04.2018, rreth orës 11:10, në Fushë-Krujë (tek tregu), pas një konflikti për motive pronësie me familjen e shtetasit S.S. janë dëmtuar me sende të forta (levë) shtetasit E.C. 17 vjeç dhe B.C. 25 vjeç, të cilët po dërgohen



Kapen "mat" duke shitur kanabis, 2 persona në pranga

SHKODËR - Policia e Shkodrës ka vënë në pranga dy persona, pasi akuzohen për shitje narkotikësh. Behet fjalë për Blendi Stankajn, 46 vjeç dhe Reid Kishën, 22 vjeç, të dy banues në qytetin verior. "Nga ana e shërbimeve të policisë "Shqiponja" në zbatim të planit të masave "Për kontrollin e lokaleve dhe ambienteve", në të cilat dyshohet se shitet dhe shpërndahet lëndë narkotike tek Palatet e Nesherakut, (lagja "Naim Gjylbegu") u kapën dhe u arrestuan në flagrancë Blendi Stankaj dhe Reid Kisha, pasi këta shtetas në momentin e arrestimit po i shisnin njëtrjetit lëndë narkotike. Gjatë kontrollit personal të Blendi Stankajt, iu gjet në një çantë një sasi lënde narkotike kanabis sativa. Ndërsa gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij iu gjet një sasi tjetër lënde narkotike kanabis sativa. Lënda e gjetur rezultoi me peshë 1.983 kg, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Materialet iu referuan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për veprën penale të "Prodhimit e shitjes së narkotikëve", thuhej në njoftimin e policisë.

"Im atë vuan nga cirroza. Kam 2 javë që blej medikamentin, një pako kushton 50 mijë lekë"

Voltiza Duro

QSUT-ja zhvat qytetarët për serumet dhe ilaçin "Human Albumine"

25 vjeçari: Ja si më mashtrroi infermierja

Prej disa kohësh, medikamenti Human Albuminë, mungon në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", duke i detyruar pacientët ta blejnë në farmaci, pavarësisht çmimit të lartë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", i riu me inicialet A. J (dëshiron të ruajë anonimitetin për shkak se i ati ende ndodhet në spital) tregon se babai i tij prej 20 ditësh është i shtruar në QSUT e vuan nga cirroza hepatike. Gjithashtu, 25 vjeçari shton se i është dashur që të sigurojë vetë medikamentin Human Albuminë, pasi QSUT-ja ia ka dhënë të atit vetëm për tri ditë, e më tej tregon i indinjuar sesi infermierja i mori paratë kundrejt premtimit që do i jepte ilaçin. Sipas tij, pavarësisht se i dha lekët, punonjësja e QSUT-së sërish nuk ia siguroi Human Albuminë. Ky ilaç i përdorur, si zëvendësues plazme kur i sëmurit ka humbje proteinash, në farmaci kushton rreth 50 mijë lekë të vjetra, çmim i papërbalueshëm për një pjesë të mirë të pacientëve. Ndërkaq, vetë burime konfidenciale nga QSUT pohojnë për "Gazeta Shqiptare" se human albuminë mungon, e madje ka raste që edhe serumet duhet të blihen nga vetë të sëmurët pasi spitali nuk ka gjendje.

Prej sa ditësh është i shtruar në spital babai juaj?
Im atë prej 20 ditësh është i shtruar në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Ai vuan nga cirroza hepatike e me këtë sëmundje, mjekët na kanë thënë që duhet ta marrë përditë medikamentin "Human Albuminë".

A iu është ofruar ky medikament nga spitali?
Joi! Në 16 ditë, vetëm 3 herë e ka ofruar spitali, ndër-sa 2 ditë baba nuk e ka marrë fare ilaçin. Ndërkohë, ne jemi



Faksimile e futurës së ilaçit human albumine, blerë nga pacienti



A ka pasur ndonjë rast ku iu është dashur t'u jepni para mjekëve për të marrë shërbimin?

Shikoja shumë njerëz që nuk reagonin, pavarësisht se e vërteta është e dukshme e madje iu thosha që të flisnin, të çonin zërin për të drejtën e tyre. Por në rastin që nuk e lufton dot sistemin, do detyrohesh ta korruptosh, jepi ndonjë lekë dhe të ndihmojnë.

A kërkuat një shpjegim nga përgjegjësit e QSUT-së në lidhje me mungesën e medikamentit "Human Albumine"?

Kemi dëgjuar që ilaçet vijnë te depot e spitalit, por që edhe mund të shiten ndoshta, sidomos këto që janë të shtrenjta. Ne i dhamë lekë një punonjësi nga personeli i QSUT-së, që na tha se do të na i siguronte ilaçin dhe sërish nuk e sollti. Kjo më bëri të indinjohesha shumë dhe që mos paguaja 50 mijë lekë duke e blerë në farmaci ilaçin, po korruptoja një infermiere. Dhe i thamë që do dërgojmë faturat në Ministrinë e Shëndetësisë, çka e frikësoi edhe më shumë infermierën.

Cila është thirrja juaj ndaj shtetit shqiptar?

Nuk besoj të zgjidhet gjë, por thjesht dua të bëj me dije se ilaçet mungojnë, kushdo që përplasat aty haset me këtë fakt, nuk janë mungesë veç për babain tim. Duhet të reagojmë ndaj abuzimeve të tilla që ndodhin në shëndetësi, pasi na prek të gjithëve.

"Ka raste kur serumet blihen nga pacientët"

Punonjësi i QSUT-së: Mungojnë medikamentet

Ndërkaq, burime konfidenciale nga personeli i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", pohojnë se medikamenti Human Albumine mungon në këtë spital. "Po! Human Albumine mungon, dhe kjo nuk është hera e parë që ndodh



detyruar të blejmë vetë këtë medikament, me rreth 50 mijë lekë të vjetra vetëm një kuti. Për vetëm katër ditë kemi harxhuar rreth 200 mijë lekë të vjetra.

Sa janë mundësitë tuaja ekonomike për të përballuar blerjen e këtij medikamenti?

Kemi arritur t'ia sigurojmë, pasi jeta e njeriut

dicka e tillë. Pacientët detyrohen t'i blejnë vetë, sepse nuk ka gjendje. Madje edhe serumet mungojnë, sidomos të shtunë dhe të dielën. Ose i themi pacientëve ka ndryshuar terapia, ose shkojnë i blejnë vetë", tregon për "GSH", një nga punonjësit e stafit të QSUT-së.

vjen mbi të gjitha. Por ky problem nuk prek vetëm babain tim, por shumë të tjerë. Ne jemi mësuar dhe nuk kemi çfarë të bëjmë, por jam tepër i indinjuar nga situa-

ta. Ky është një ilaç shumë i shtrenjtë që vetëm një përqindje shumë e vogël e familjeve shqiptare mund ta përballojnë blerjen e tij. Këtë herë e pashë situatën me sytë e mi dhe është një abuzim, duhet të shembim fasadën e shëndetësisë "falas".

Si ishte shërbimi i ofruar nga stafi mjekësor i QSUT-së?

Në urgjencën e QSUT-së, kur e çuam fillimisht shërbimi ishte skandal, kishte mjekë që flinin gjumë, të tjerë që nuk të prekinin me dorë. Këtë herë e kemi çuar në spital gjatë ndërrimit të turneve të mëngjesit, sepse gjendja shëndetësore e babait u përkeqësua, dhe shkua të traumatizuar. Na u desh të prisnim shumë, por vetëm me sherr e të bërtitura ia arrita që ta merrnin nën kontroll babin. Në këtë shtet, po nuk pate lekë, vdes!

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – RFP for "Capacity building on Code of Administrative Procedures (CAP) implementation and adopting local government Standard Operating Procedures (SOPs)".

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 45302**

RFP for "Capacity building on Code of Administrative Procedures (CAP) implementation and adopting local government Standard Operating Procedures (SOPs)".

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 23-Apr-18
Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org
Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 1 vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,384,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 1 vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 03 Maj 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Hidhet dritë mbi 500-vjetorin e heroit në sheshin "Shën Pjetër"

Prill 1968, si e tronditën Romën antikomunistët shqiptarë në festimet për Skënderbeun

Nga Ylli Polovina

Në 1968-ën, nën siglën "Tepër sekret", një material i shkruar i Ministrisë së Punëve të Jashtme për Komitetin Qendror të PPSH-së, i cili titullohej "Buletin" dhe mbante numrin 46, thoshte: "Vatikani organizoi me bujë gjatë prillit ceremoni të ndryshme me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Para arbëreshëve dhe emigrantëve reaksionarë shqiptarë mbajti një fjalim të shkurtër e demagogjik edhe vetë Papa Pavli i VI. Këtyre ceremonive Radio-Vatikani, Roma e "Zëri i Amerikës", u munduan t'u japin ngjyrën "miqësore" e "dashamirëse" të "qytetit të shenjtë" karshi popullit tonë. Bile në fjalimet e ndryshme nuk munguan të theksonin edhe shumë nga karakteristikat burrnore të popullit tonë".

SI ËSHTË E VËRTETA?

Çfarë pati ndodhur realisht në Romë në prill 1968, ndërsa festimet e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit gjithkund e jo vetëm në Tiranë, duke qenë se përkoinin me ditën e 17 janarit, u organizuan në këtë moment të vitit. Në Tiranë një kuvend i tërë shkencor u mbajt nga 13 deri në 17 janar (Konferenca e Dytë Albanologjike). Në këtë periudhë u kryen festime masive edhe në Romë, ku u përfshinë edhe arbëreshë. Në pjesën më të madhe të tyre që mbështetja e Ambasadës Shqiptare.

Mirëpo në Prishtinë përkujtimi me veprimtari shkencore i jubileut të Skënderbeut u zhvillua nga 9 deri në 12 maj, kurse në mbyllje të vitit 1968 do të ishte konferenca shkencore në Universitetin e Palermos (28 nëntor-1 dhjetor).

Madje, përvjetori pesëshekullor do të shënohej me një konferencë me kumtesa historike mjaft cilësore edhe në qytetin e Barit. Kjo ishte e para që u krye në Itali: 21-22 tetor 1967.

Një muaj e diçka më parë tek kjo e përditshme, "Gazeta Shqiptare" përkshruam në dy numra se si ndodhi që

në festimet e këtij përvjetori të përplaseshin qeveria e Tiranës me grupet e diasporës antikomuniste në Francë, një dukuri që ra shumë në sy, sepse lidhej me nderimin e emrit të Skënderbeut, por ku njëra palë përjashtonte tjetrën. Bëhej fjalë për një gjendje tensioni që zgjati një dekadë të tërë për çështjen e emërimit të Sheshit "Skënderbej" në Paris.

Këtu përballë Tiranës zyrtare dhe ambasadës së saj në kryeqytetin francez, e cila ishte penguese për thirrjen e këtij sheshi me emrin e heroit tonë kombëtar, ishte

Beteja mes antikomunistëve dhe komunistëve për të përkujtuar 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut

jëshëm. I treti do t'i dorëzohet redaksisë pas një distancë të paktën dyjavore. **GAZETARI ARBËRESH SHPJEGON**

Në 11 dhjetor 2003, gazetari arbëresh Okio Tiberio (Ochio Tiberio), i së djathtës radikale, i bëri një intervistë Arkimandritit Eleuterio Francesko Fortino (Eleuterio Francesco Fortino), i cili

së gazetarit Tiberio "Ju gjatë vitit 1968 keni qenë sekretar i përgjithshëm për festimet e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Çfarë kujtime ruani?", Arkimandriti iu përgjigj: "Ishte me të vërtetë një ngjarje e jashtëzakonshme. Përfshiu të gjithë diasporën shqiptare. Them diasporën, por pati ndikim edhe në Sh-

zojmë për lexuesin, ka qenë një katolik dhe antifashist i njohur, për tri dekada deputet dhe tri herë ministër i shtetit italian. Ai kishte lindur në qytezën arbëreshe Specano Shqiptare (Spezanno Albanese).

Sipas Arkimandritit Eleuterio Francesko Fortino, "Festimet e jashtëzakonshme romane u zhvilluan nga 24 deri në 26 prill 1968 dhe përbëheshin prej një cikli veprimtarish. Në fillim u organizua një kuvend në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan, me pjesëmarrës nga krahinat italiane të Molises, të Bazilikatës së Kalabrisë, prej Sicilisë si edhe nga vende të tjera të botës (Kanada, SHBA, Australi).

Po ashtu, u krye një pritje nga Papa, Shenjtëria e Tij Pali (Paolo) VI.

Në vijim në Sallën e Madhe të Institutit Papal Lindor u mbajt një mbledhje përkujtimore. Më tej u bë një lutje në kishën Basilica e San Pietro në Vatikan. Pas kësaj u zhvillua një homazh para monumentit të Gjergj Kastriotit në Piazza Albania. Më në fund u bë një pelegrinazh në Xhenacano (Genazzano), Viterbo, pranë Romës. Në kishën e qytetit është vendosur ikona e madhe e "Zonjës së Shkodrës".

Pyetjes së Okio Tiberios për ndonjë prani të pasardhësve të Skënderbeut në festimet e 500-vjetorit të vdekjes së Heroit, Arkimandriti Fortino iu përgjigj me fjalët "Grupet arbëreshe qenë me në krye Ferdinando Kastriota Skanderbeg, baron i Fosçekës dhe i Kasteluços, si edhe prej djalit të tij Xhorxho".

Gazetari, kurioz të dinte se si qe shprehur, gjatë takimit me grupin përfaqësues të komitetit të festimeve, Pali VI, mësoi se "Ajo çfarë tha Papa do të mbetet përherë në zemrat tona. Na ngriti peshë duke thënë "Shumë të dashur bij të Shqipërisë, mirëseardhja jonë speciale sot është për ju, të mbledhur pranë kësaj selie Apostolike, të cilën mund ta konsideroni shtëpinë tuaj atërore, për të kujtuar Pesëqindvjetorin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Hero i Kombit tuaj



Mes Arbëreshëve Antony Athanas dhe Nelo Drizari

dhe i emrit të të Krishterit. Ju shohim e ju takojmë me shumë dëshirë: në fakt e dimë që shpirti me të cilin po festoni këtë datë përkujtimore, është vetë tradita e etnisë tuaj, e cila mbi të gjitha i ka sublimë Besën dhe Besnikërinë për të tëra angazhimet e mara, atë të Nderit ose të ndjenjës së ndershmë të Burrnisë, të cilat janë virtyte të mëdha...".

Kur Tiberio gjatë intervistës tha se "Dimë që komiteti organizativ i shpërndau ftesat për të gjithë shqiptarët që e identifikonin veten me dëshirën për të kujtuar këtë përvjetor, pra që ishin të të gjitha qëndrimeve politike". Eleuterio Francesko Fortino shtoi që kjo ishte shumë e vërtetë. Ata i patën dërguar ftesa edhe qeverisë së Tiranës si edhe ambasadës shqiptare në Romë, në rrugën "Asmara". "Por, nuk morëm asnjë përgjigje", shpjegoi Arkimandriti. "Qëndrimi i regjimit të Enver Hoxhës ishte, mbase, i kuptueshëm në momentin që Heroi ynë Kombëtar po festohej veçanërisht si Atlet i Krishtit dhe si Mbrojtës i Qytetërimit Perëndimor...".

PJESËMARRËSIT "REAKSIONARË"

Këto festime do të qenë katër ditë të plota, duke u shndërruar në histori si ngjarja më e madhe ndëruere për Skënderbeun jashtë vendit në atë 500-vjetor.

Sipas programit, e para veprimtari e këtyre katër ditëve do të qe ceremonia fetare në "Shën Pjetër". Ish-te ora 10.00 e paradites së



Vatikan, Pjesëmarrës të veprimtarisë

një nga nismëtarët e veprës së emërimit të tij, i shumëdituri kundërkomunist Lec Shllaku.

Por ndërsa në Paris në krye të antikomunistëve ose thjesht të mospartituesve me sistemin shoqëror e politik të vendosur në Shqipëri, qenë disa intelektualë të emigruar dhe në bashkëveprim me ta nuk funksiononte posaçërisht ndonjë institucion i rëndësishëm i shtetit përveç kryetarit të Bashkisë së Parisit Zhak Shirak, në Romë pati hyrë në veprim vetë Selia e Shenjtë, një shtet ndërkombehtar.

Ja pse kjo histori, e cila asnjëherë për lexuesin shqiptar nuk është bërë e ditur në tërë kompleksitetin dhe hollësitë e saj, përbën lëndën e këtij shkrimi, i cili edhe ky do të jetë fillimisht në dy numra të njëpasnj-

që prej 21 majit 1987 në Vatikan ishte me funksionin e Nënsekretarit të Këshillit Papal për Unitetin e të Krishterëve.


Duke qenë arbëresh dhe vëlla i studiuesit dhe profesorit në Universitetin Oriental të Napolit, shefit të Katëdrës Shqipe, Italo Fortinos, kleriku i lartë deri sa ndërroi jetë në 22 shtator 2010, për një dekadë rresht, punoi për frymën bashkuese mes Selisë së Shenjtë dhe Kishës Ortodokse. Për këtë mision të realizuar suksesshëm, në vitin 2007, mori çmimin "Trëndafilin e Artë". Në 2009 iu gëzua edhe një çmimi që e mbuloi me hare, "Arbëria".

Informojmë lexuesin se Nënsekretar në shtetin e Vatikanit është një lloj postë të zyrtar i përafërt me atë të një ministri.

Gjatë intervistës pyetjes

qipëri. Festimet u organizuan nga një Komitet Qendror në të cilin unë isha sekretar... President i tij ishte avokati Xhenaro Kasiani (Gennaro Cassiani) dhe nën-president profesor Xhovani Lala Comneni (Giovanni Lala Comneno). Bashkë me ta qenë rreshtuar edhe mjaft personalitete të shquar arbëreshë dhe shqiptarë... Komiteti për festimet ia doli të realizojë në Romë një pjesëmarrje entuziaste dhe vëllezërore të shumë italo-shqiptarëve dhe të shqiptarëve të shpërndarë nëpër botë, të lidhur fort me kujtimin e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Skënderbe. E përkujtuam me dinjitet shpirtin e tij të bashkimit dhe të jetës e luftës, që bëri në mbrojtje të Shqipërisë apo të Perëndimit të krishterë".

Xhenaro Kasiani, nënvi-



24 prillit 1968 kur pjesëmarrësit u mblodhën në sheshin e Vatikanit, atje ku e kishin paracaktuar: tek Obelisku.

Pak kohë më parë grumbujt e vazhdeve arbëreshe me kostume popullore që binin shumë në sy mes banorëve të Romës, si edhe gjithë të tjerët mund t'i dalloje lehtë nëpër rrugët e kryeqytetit italian, sidomos kur hynë në të gjerën udhë 'Via della Conciliazione', që të çon drejt për së drejti në Shën Pjetër.

Të ardhur nga qytete dhe qyteza të ndryshme të Italisë, por edhe prej Francës, Gjermanisë, Belgjikës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku kishite diaspora të fushime antikomuniste, që të gjithë e ndjenin veten pelegrinë fetarë. Ceronitë dhe aktivitetet do të qenë të gjitha të frymëzuara nga profili katolik i veprës së Skënderbeut, më saktë prej misionit të tij një çerek shekullor në mbrojtje të Evropës së Krishtit në Perëndimore.

Ky që koncepti themelor i atyre katër ditëve. Pelegrinët ardhës, adhurues të këtij roli të Gjergj Kastriotit, e shpallnin hapët që patën mbërritur në Romë nga "Bota e Lirë".

Duhet të saktësojmë me këtë rast se Vatikanit, edhe pse bënte kujdes diplomatik në raportet me vendet e ish-kampit socialist, po ashtu tregonte maturi për të mos i ashpërsuar me vend dhe pa vend deklarimet politike ndaj tyre, ishte në thelbin e vet qartësisht antikomunist.

Sidomos në rastin e qeverisë së Shqipërisë kjo që një prirje shumë e theksuar.

Organizatorët e atyre katër ditëve në përkujtim të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, e kishin deklaruar që të ftuarit i patën zgjedhur "pa dallim partie dhe krahine", por siç do ta shohim në vijim, kjo nuk që tërë e vërteta.

Në orën 10.00 masa e madhe e ardhësve, ku jo pak dukeshin të mallëngjyer, ndonjë që edhe i përplotur, nga Obelisku u drejtua tek Kisha e Shën Pjetrit, në të cilën do të mbahej një meshe për kryeheroin shqiptar, por njëkohësisht edhe Atletin e Krishtit. Pikërisht kur mbërritën këtu dhe zunë

vend, u panë në rreshtat e para Ferdinand Kastrioti Skënderbeu dhe Ferdinando Castriota-Scanderbeg me të shoqen dhe motrën e tij. Pasardhësi i Skënderbeut me banim në Napoli pati marrë me vete edhe të birin e tij, Gjergjin (Giorgio). Pjesëmarrësit e thërritnin "Princ".

Ndodhej po ashtu Dhimiter Berati, të cilit i drejtohehin me titullin "Shkëlqesi". Ai që një ndër firmëtarët e Deklaratës së Pavarësisë si edhe drejtori i parë i gazetës së qeverisë së Ismail Qemalit, "Përlindja e Shqipërisë".

Pranë tij rrinte Nexhat Peshkëpia, përfaqësues i Komitetit "Shqipnja e Lirë" me qendër në Nju Jork. Atij i drejtohehin

me titullin "Profesor". Në krye të vendosjes së pjesëmarrësve në kishë ishte edhe deputeti arbëresh e njëkohësisht personaliteti i spikatur në Universitetin e Palemos, Rozolin Petrota. Që bashkë me të shoqen dhe të birin. Këtë e thërritnin Turi. Ndodheshin po ashtu studiues italian me kontribues për historinë mesjetare të Shqipërisë, At Zef Valentini.

Kryetari i Komitetit Qendror organizues, Xhovan Lala-Komeni, të cilit i drejtohehin me fjalët nderuese "Profesor-Doktor", ishte i pranishëm me në krah bashkëshorten. Dallohej dukshëm mes figurave më të rëndësishme të festuesve Zef Serreqi, të cilin e quanin me titullin i dikurshëm të periudhës së Ahmet Zogut, "Gjeneral".

Qenë në rreshtat e para të meshe që do të mbahej në Kishën e Shën Pjetrit, edhe figura të ditura si Renato Markiano (Renato Marchiano), Profesor Agostino Matarello (Agostino Mattarello). Ishte i dallueshëm dhe fort i nderuar prej pjesëmarrësve Profesor Xhuzepe Skirò i Riu (Giuseppe Schirò jr).

Tërhiqte vëmendjen me gjallërinë dhe autoritetin e tij njëri prej organizatorëve të të gjitha veprimtarive kushtuar Skënderbeut në Itali në atë 500-vjetor, njëkohësisht edhe antikomunist i paepur: Profesor Ernest Koliqi. Ai ndodhej aty bashkë me të shoqen.

Që e pranishme në rreshtat e para të pelegrinëve zonja Dudush Vrioni (Këlcyra), e shoqja e Ali Këlcyrës, ndërsa ky mungonte sepse pati nderuar jetë.

Nuk mungonin po ashtu edhe Namik Resuli, të cilin e thërritnin "Profesor". Në krah kishte të shoqen dhe të bijën. Ndodheshin aty edhe Nikolla D'Alena (Nicola d'Alena) me bashkëshorten, Rrok

Nallbani, të cilit ende i shonin gradën e dikurshme ushtarake, "Majror".

Qenë gjithashtu Vehbi Frashëri me Ragip Frashërin, Ismail Vërlaci, eksponenti i njohur i Ballit Kombëtar Vasil Andoni, gjendeshin Zef Pali, Sulejman Meço, Ahmet Bej Resuli, Nexhmedin Vrioni, Ekrem Telxha, Ismail Sefe, Seit Demneri me të shoqen, ardhur nga Australia, Nikollë Shkoza, Gaspër Serreqi, farmacisti i njohur Ismail Boçari, Nos Qirjaku, Albert Akshia, Omer Fortuzi, Asllan Zeneli, Tomazo Plesha (Tommaso Plescia) me bashkëshorten, Ndue Gjomarkaj (ky thirrje me titullin "Kapiten"). Që bashkë me të shoqen.

Ishin të pranishëm gjithashtu Albino Greko (Albino Greco), drejtor i Revistës "Zgjimi", Abaz Ermenji gjithkund i thirrur me titullin "Profesor", dijetari Martin Camaj, albanolog në Gjermani, pedagogu i letërsisë shqipe në Universitetin e Romës, Xhuzepe Gradilone (Giuseppe Gradilone), piktorët e njohur Ibrahim Kodra dhe Lin Delija. Po ashtu që Lec Shllaku i ardhur nga Franca dhe Prof. Nino Guxeta (Nino Guzetta) nga Palermo.

Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte pjesëmarrës dukshëm i nderuar prej njerëzve përreth kryetarit i Shoqatës "Vatra", Antony Athanas. Që me bashkëshorten Esther. Po ashtu, ndodhej aty edhe kryetari i nderit i shoqatës, Christo Thanas, botuesi i gazetës "Dielli" të "Vatras", Peter Chicos me të shoqen Nicolina, autori i njohur i një libri të suksesshëm për Skënderbeun, Nelo Drizari...

Nuk mungonin shumë priftërinj shqiptarë: Don Prenk Ndrevashaj, Don Daniel Gjeqaj, At Jak Marlekaj, At Ambroz Martini, At Paulin Margjakaj, At Vincenc Malaj... Ndërsa mbahej mesha për Gjergj Kastriotin në

vendet e para të ceremonisë kishin zënë vend krerët e Vatikanit, "Ndriritësit e Tyre Kardinal Maksimilian e Fiirstenberg, Prefekti i Kongregacionit të Shenjtë për Kishën Lindore dhe Pietro Agagianian, Prefekti i Kongregacionit të Shenjtë për Unjillizimin e Popujve.

KUNDËRVEPRON AMBASADA SHQIPTARE

Një nga pjesëmarrësit nëpërmjet kujtimeve të tij të botuar në 1968 në një broshurë të Universitetit të Palemos, duke ndjekur meshejn për Skënderbeun në Kishën e Shën Pjetrit (e quajtur edhe kryekisha e Vatikanit), do të linte pas këto fjalë: "Gjysmëterri i Kishës, fjalat e tymit të kemit (thimjamës), melodi të bizantine, na bënë të tresim në mendime: mendja e jonë fluturonte atje larg në Shqipni: na u përlytroshin kishat e rrënueme e të djeguna, shërbtorët e Perëndisë të përndjekun, të vramë, të pushkatuem, të kalbun nëpër burje, të tallun e të nëpërkambun, të shamë e të pështymë, të dëbuen nga shtëpijat e kuvendit. Na dëlshin përpara vuetjtje të pafajshmëvet, lotët e nānavet të mbetuna pa djetm..."

Ndërkohë këtë paradite të 24 prillit 1968 Ambasada Shqiptare në Romë nuk rrinte dukarqy. Ajo kishite nxitit dhe organizuar një veprimtari tjetër, të inkuadruar posaçërisht në një ngjarje shumë të madhe dhe të dashur për popullin italian: 25 prillin, ditëçlirimin e tij nga diktatura fashiste e Benito Musolinit dhe trupat naziste të Adolf Hitlerit.

E informonte ajo Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë: "Në datën 24 prill, me rastin e Ditës së Rezistencës, u mbajt një konferencë mbi Luftën Nacional-Çlirimtare në Shqipëri dhe u fol mbi temën (R.P. e Shqipërisë, fener dritësues i socializmit në Evropë)..."

(Vijon javën e ardhshme)



Tiberio Oçhionro, Ylli Polovina në Romë në nëntor 2001

SULMI NE TURQI NGJARJA

Dogukan B ishte shkarkuar nga detyra pasi dyshohej se ishte pjesë e një organizate terroriste

Turqi, sulm me armë, 4 të vdekur

Arrestohet autori, studiues në Universitetin Eskisehir

TURQI

Një sulm me armë ka ndodhur gjatë ditës së djeshme në Universitetin e Eskisehirit, në veriperëndim të Turqisë ku kanë mbetur katër të vrarë dhe tre të plagosur. Mediat turke bëjnë me dije se agresori është Dogukan B. studiues në Universitetin e qytetit Osmangazi. Autori i sulmit për motive ende të panjohura qëllori për vdekje katër kolegë të tij.

NGJARJA

Gjatë mesditës së djeshme Dogukan B studiues në Universitetin e Eskisehirit ka qëlluar me armë zjarri pjesëtarët e stafit të universitetit duke lënë të vrarë 4 persona dhe 3 të tjerë të plagosur. Rektori i universitetit tha se viktimat të këtij sulmi kanë rënë z.v.dekani i Fakultetit të Edukimit, Mikail Yalcin, sekretari i Fakultetit Fatih Ozmutlu; lektori Serdar Caglak dhe ndihmës lektori Yasir Armagan. Tre të plagosurit nga sulmi janë transferuar menjëherë në spital. Doukan B. është arrestuar pasi është dorëzuar vullnetarisht. Sipas rektorit të universitetit, Hasan Gonen agresori mësyu fillimisht zyrën e dekanit dhe qëllori një person aty brenda më pas, ai qëllori edhe 3 pjesëtarë të tjerë të stafit, në



Dogukan B., autori i sulmit në Universitetin e Eskisehirit

katet e mësipërme të ndërtesës, përpara se të largohej nga godina. Punonjësit e emergjencës shkuan menjëherë në vendngjarje, për t'iu ardhur në ndihmë studentëve dhe pedagogëve të tjerë të shokuar. Motivi i këtij sulmi mbetet ende i paqartë, ndërkohë guvernatori i provincës Ozdemir

Cakacak ka emëruar tre prokurorë për të hetuar dhe zbardhur ngjarjen e rëndë. Sipas raportimeve bëhet me dije se asistenti i kërkimeve shkencore ishte shkarkuar nga detyra. Shkak i shkarkimit ishin dyshimet se Dogukan B ishte pjesë e një organizate terroriste të quajtur fethyllahiste.



Dyshimet

DOGUKAN B

Dogukan B, autor i sulmit me armë në Universitetin e Eskisehirit, ishte asistent i kërkimeve shkencore. Ai ishte shkarkuar më herët nga detyra pasi dyshohej se kishte lidhje me organizatën terroriste fethyllahiste dhe po hetohej mbi këtë.

SHKURT

Greqia dëbon 668 shqiptarë, shkak qëndrimi i paligjshëm

GREQI- Gjatë muajit mars 1181 qytetarë të huaj janë dëbuar nga shteti grek, duke u kthyer në vendet e tyre të origjinës për shkak të qëndrimit të paligjshëm dhe dokumenteve të parregullta. Pjesa më e madhe e të kthyerve janë qytetarë shqiptarë. Kryesisht 668 shqiptarë janë dëbuar nga Greqia ndërsa qytetarët e tjerë i përkasin shteteve nga Pakistani, Iraku, Gjeorgjia, Algjeria, Turqia, Bullgaria, Irani dhe Afganistani. Sipas shifrave zyrtare, për vitin 2017 nga Greqia janë dëbuar 20.255 shtetas të huaj, të cilët janë kthyer në vendet e tyre të origjinës.

Përfshihet nga flakët spitali në Stamboll, evakohen pacientët

TURQI- Një zjarr i përmasave të mëdha ka rënë në një spital në Gaziosmanpasa në Stamboll gjatë pasdites së djeshme. Zjarri ka përfshirë të gjithë katet e spitalit. Një numër i madh zjarri-fikuesh dhe ambulancash mbërritën në vendngjarje, të cilat bënë të mundur shuarjen e flakëve dhe evakuimin e të sëmurëve. Zjarri raportohet se fillimisht ka nisur në pjesën e catisë, por brenda një kohe shumë të shkurtër është përhapur në të gjitha katet. Deri më tani nuk janë raportuar viktima ndërsa të rrezikuar nga zjarri janë edhe pacientët që ndodhen në reanimacion.

Kurz: Të gjitha vajzat të kenë të njëjtat mundësi në Austri

Austria, kërkon ndalimin e mbajtjes së burkës për vajzat në kopshte dhe shkolla

Po përgatisim një ligj me vlerë simbolike për të ndaluar mbajtjen e burkës për vajzat në kopshte dhe shkollat fillore të vendit", njoftoi gjatë ditës së djeshme qeveria austriake e kryeministrit konservator Sebastian Kurz, aleat i ekstremit të djathtë. "Ne dëshirojmë që të gjitha vajzat të kenë të njëjtat mundësi në Austri", tha Kurz. Gjatë krizës së emigracionit në Europë, Austria pranoi azilkërkues në nivelin më shumë se 1% të popullsisë

SITUATA

"Gjendemi përballë një fenomeni në rritje. Disa dekada më parë, një e tillë nuk ekzistonte në Austri, ndërsa tani, shohim jo vetëm kopshtet islamike, por edhe institucionet publike në Vjenë e qytete të tjera të vendit"

së saj, por ishte pikërisht kjo çështje që ndihmoi konservatorët e Kurzit të fitonte zgjedhjet vitin e kaluar falë ndjekjes së një linje të ashpër kundrejt emigracionit. Pjesë e saj, siç shpjegon tani kancelari, është dhe hejja

e shamive të kokës për femijet në shkollat fillore dhe në institucione parashkollore. Nëse ky plan do të kthehet në ligj, ai do të jetë i detyrueshëm për vajzat deri në moshën 10 vjeç. "Ajo që mund të them është se gjendemi përballë një fenomeni në rritje. Disa dekada më parë, një e tillë nuk ekzistonte në Austri, ndërsa tani, shohim jo vetëm kopshtet islamike, por edhe institucionet publike në Vjenë e qytete të tjera të



vendit" - shprehu Kurtz. Sakaq, as Ministria e Arsimet, as ekspertë të ndryshëm nuk janë në gjendje të jepnin shifra të sakta se sa vajza mbajnë aktualisht shami koke në kopshte dhe shkollat fillore.

Shkodër, 135 pronarët që kanë gati lejet e legalizimeve për shtëpitë

Leje e fatura, ALUIZNI publikon listat e përfituesve

Tiranë, gati faturat për parcelat ndërtimore

Ornela Manjani
Drejtorja e ALUIZNI-t publikon listat me pronarët që kanë ndërtuar pa leje në Tiranë dhe kanë gati faturën për parcelën ndërtimore. Gjithashtu, 'Agjencia' publikon edhe listën me 135 pronarët që kanë gati lejet e legalizimeve.

me 135 persona që kanë gati lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në qarkun e Shkodrës. Procedurat për marrjen e tapive do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë. Pas regjistrimit të lejes së legalizimit, pronari pajiset me certifikatë pronësie, të cilën duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive për ta tërhequr. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje të lejes së legalizimit për të vërtetuar

mbarimin e procesin të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Palaujtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë, sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së

drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi, jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat

për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen me vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve, në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjekti mund të përfaqësojë përveç pjesës takuese, edhe pjesë fizike respektive nëse ndërmjet tyre përpunet vullnetin.

PRONARËT QË KANË GATI LEJET E LEGALIZIMEVE PËR SHTËPITË

Table with 2 columns: EMER, ATESI, MBIEMER. Lists names of owners.

Table with 2 columns: NJESIA. Lists the number of units for each owner.

Table with 2 columns: FATMIR ISLAM, ISLAM QAMIL. Lists names and addresses of owners.

Table with 2 columns: ZELA, NJESIA. Lists names and unit numbers of owners.

Table with 2 columns: KASTRIOT, QANI, MAKSUTAJ. Lists names and addresses of owners.

Table with 2 columns: NJESIA. Lists unit numbers for owners in the rightmost section.

Leje te printura Mars 2018

Table with 2 columns: Nr, Pronar, Adresa. Lists 135 entries of owners and their addresses.

Table with 2 columns: Nr, Adresa. Lists 135 entries of addresses.

"POPULLI QË ECTË NË ERRESIRË PA NJË DRITE TË MADHË"

Kryepeshkopi Anastas...

Ngjallje e besimit... ortodoksisë... dhe shqiptarëve



FERDINAND SAMARXHI
MJESHTËR I MADHË

EJANI TË NGAZËLLOHEMI ME ZOTIN...

Vitet 1967 - 1991. Tokë e djegur. Shpirtira të zhuritur... apo teoz, drejtuar Zotit të ndaluar! Mjeguullinajë e zezë dhe e rëndë. Shqipëria përjeton terr shpirtëror. Shpresë e vogël, qirinjtë të ndezur nuk mund të ndriçojnë shpirtin. **"Populli ecte, - siç thotë Shkrimi i Shenjtë, - në luginë e hijës dhe të vdekjes"**. Krishtin e kishin mohuar, kryqëzuar dhe varrosur. Zot nuk ka. Më ai s'ezgiston. Kjo përcillej tek të gjithë si një brengë ogurze për të varrosur në mendjet e njerëzve se përëndi nuk kish se ajo ishte opium për ta. Kambanat, që sillnin nga hera Ngjalljen e Zotit, Krishtit mbret dhe ato kishin pushuar. **"Vargonjtë e vdekjes më kishin rrethuar dhe anktet e Sheolit më kishin pushtuar; fatkeqësia dhe dhembja më kishin vënë përfund"**. Heshitje varri. Ora për shqiptarët kishte ndaluar të premtën e zezë! Jisuin, e kishin mbyllur në varr: Duhet të vinte e Diela e Zotit, që kambanat të fillonin përsëri, simfoninë e bukur të Ngjalljes. Ishte e nxënë Shqipëria, ishin të drobitur shqiptarët për atë pakëz dritë të llambadës së Pashkës, që të do të shponte errësirën e ftohtë, që kishte mpleksur çdo jetë, çdo zemër, çdo bari të grigjës. Kur do të ngjallej Krishti për shqiptarët? Në këto kushte sado dëshpëruese, ftesa e së krenmtës të ndritshme e Pashkës, siç mundi dhe dërrmoi Krishti pushtetin e vdekjes dhe ndriçoi gjininë njerëzore do të ndryshonte ecurinë e botës, perspektivën dhe dinamikën e jetës sonë. Krishti më dërrmimin e vdekjes në këtë ftesë paskale do t'i jepte kuptim të ri qenies njerëzore, shqiptarëve, do t'i ftonte ata në pjesëmarrje në triumfin e Krishtit fitimtar. Krishti ftonte në besim dhe ofronte shpëtimin për kapërcimin final të vuajtjeve, kryqëzimit dhe vdekjes së jetës së shqiptarëve.

Kishin filluar të frynin orërat e ngrohta të besimit. Krishti thërriste **"Ejani pra, le të ngazëllohemi me Zotin"** sepse ngjallja ime do të pasojë, dërrmimin e kompleksit që lidhet me vdekjen, tmerret e persekutimit të egër barbar komunist. Krishti i ngjallur, që po vinte tek ne, do të dhuronet fuqi për përmbyesjen e tyre, për vdekjen, dëshpërimin dhe vuajtjet e tyre. Po afrohej e Diela e Zotit! Himnet dhe troparet e kësaj dite, ftonin dhe po paralajmëronin shqiptarët se Zoti ish ngritur nga varri, nuk ish më i vdekur për ta, siç u shfaq grave mirorurësë, me zërin e engjëjve që i u thanë: **"Pse kërkoni të gjallin, ndër të vdekurit? Ai, nuk është më këtu. Shkoni dhe u thoni Pjetrit dhe nxënësve të tij, se ai po shkon më parë se ju në Galileë"**. Pra, Zoti ishte ngjallur. Liria e kishje sjellë atë edhe me nesh. Apostujt e tij po përhapnin lajmin e ngjalljes.

Në luginë e shkretë dhe të vdekur që Shqipëria përjetonte ethet e fundit, në rrugëtimin e jetës sime, tashmë, prej afro gjysmë shekulli



Apostol i krishtit në Shqipëri. Me Presidentin e Shqipërisë Z. Meta, ditën e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë

si gazetar, në atë terr shpirtëror të tokës së djegur për Zotin, lirinë e besimit, të fjalës, të tubimit, do të njihja që në fillimet e viteve '91, di sheputjet e mëdhenj, si Baba Reshat Bardhin, hirësinë e tij Hafiz Sabri Koçin, Kryepeshkopin Anastas, Dom Mikel Koliqin (kardinalin e mëvonshëm), Dom Ernest Troshanin (kardinalin e sotëm), Monsinjon Frano Iliajn etj., që do të ndriçonin dhe do të thërrisnin në altar in e shenjtë zërin e Zotit, që Ai të kumbonte fort dhe fuqishëm në zemrat e njerëzve. Do të ndërtonin në zemrat e tyre një kishëzë, një xhami, një teqe, do të bënin që të lindte tek ata një Zot në zemrat e tyre. Qindra kisha, manastire të besimtarëve të krishterë ortodoksë ishin të djegura, të shkretuara dhe të rrnuara tërësisht. Barinjtë e tyre ishin burime; internuar, persekutuar dhe vrarë. Grigja ishte pa bari. Në këto kushte varri dhe heshitje, një bari, episkopi i Andrusës, edhe pse vinte nga një vend si Afrika, ku dhe atje Jisuin nuk e përjetonin, do të njihja një bari Perëndie, me plot patos që e kish në zemër me gjithë dashu-



Epremtë e zezë. Të gjithë presim ngjalljen e Krishtit. Pashkë 1992

ri Krishtin, që do të pranonte dhe barazonte jetën me vuajtje, që do të kalonte në kalvarin e 14 stacioneve të udhës së kryqit të Shqipërisë, së kohës së egër komuniste, që do të ndiqte gjurmët e udhës së Krishtit, teksa ai po shkoi tek drejt tij.

"Hosana, Hosana, i bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit". Kryepeshkopi Anastas kishte ardhur më në fund, në Shqipëri, si një dhuratë Perëndie, si bekim i Zotit, si ngjallje për shqiptarët, si ngjallje për ortodoksizmin; ashtu si kuptimi i emrit të tij 'ANASTAS', që do të thotë NGJALLJE. Po, kishte ardhur me të vërtetë Kryebari, që do të ngjallej dhe do të thërriste me ngazëllim grigjinë e tij: **"Zoti është me ne dhe ne me Zotin"**, "Nuk do të braktis Perëndia", "Erdhi ora e Zotit", "Krisht-

ti u ngjall".

Në këto kushte të tmerrshme, Kryebari ynë, Kryepeshkopi Anastas, do të shkelte për herë të parë në tokën e Shqipërisë në 17 korrik 1991, kur erdhi si Eksark Patriarkal, i dërguar për të parë gjendjen e Kishës Ortodokse në Shqipërisë. As hierarki, as sinod, as institucion, çdo gjë e paralizuar dhe e vdekur. Pothuajse nga tri episkopatat, 19 zëvendësitë hierarkike, 330 enorët dhe 25 manastiret, që kishin të Kisha në administrim para 1967, nuk kishte mbetur asgjë, pasuritë kishitare ishin të konfiskuara. Kishat të transformuara në depo, stalla, reparte ushtarake dhe shtëpi kulture.

Nga të gjithë klerikët kishin mbetur vetëm 12 përfundim, asnjë episkop dhe madje shumica ishin të plakur dhe të sëmurë. Kjo ishte therëse, trishtuese.

Pamja, madhështia e tij fisnike dhe hyjnore, fliste shumë, për sot dhe të ardhmen. Në përfytyrimin dhe botëkuptimin tim të kohës, e njehsova njëherësh dhe e quaj edhe sot dhe për të ardhmen, një nga dymbëdhjetë apostujt e Krishtit, si Shën Pavli, që themeloi kishën në Ilirikum, dhe e përhap, ungjillin, nga Jerusalemi deri në Ilirikum. Ky është kryebari, që nuk u tut piskamës së vdekjes së kishës. Çdo gjë duhej filluar nga e para. Edhe optimistët, ishin pesimist. Gjendja ishte alarmante. Ku të fillonjë të meshohej? Nuk kishte rrugë tjetër. Duhet të meshohej dhe në kishat me mure të rrnuara dhe në kisha pa çati dhe në qiell të hapur. Dhe aty, kryebari ynë thërriste me shpresë: **"O Zot, o Zot, shtjerr syrin prej qiellit, edhe shiko, edhe vizito, këtë vreshtë që e ka mbjellë dora jote e djathtë"**.



Krishti u ngjall për Shqiptarët. Pashkë 1992

Me kërsëri dhe besim të fortë Perëndie, kudo filloi të dëgjohej fjala e Zotit. Kudo filloi të ringrireshin muret e shtëpive të Tij, si një herë e një kohë të Dhjatës së Vjetër: **"Hyji në portat e tij, me falënderim dhe në oborret e Tij, me lavde, kremtojmë, bekonim emrin e Tij"**. Do të udhëtonte kryebari ynë, në të

gjitha anët e Shqipërisë, në çdo krahinë e qytet të vendit, se dhe klerikë nuk kish. Do të mesohnte pa u lodhur. Do të ngjallte shpresë pa pushtim, kurrë nuk do të ndalej dhe para shpirtit të pashpresë. Stoik. Tek ata që nuk njihnin Zot, tek ata që nuk ishin lutur, prej shumë vitesh, tek ata që e kishin mohuar të detyruar Atë. Duhet përballur me një kishë inekzistente. Me një kishë, që kishte qenë e dobësuar, që gjatë periudhës së pushtimit osman dhe nga shpallja e autoqefalisë, vetëm dy vjet kish qenë e lirë, se më pas pushtimi fashist dhe persekutimi i egër komunist, plotësisht e kish të rrnuar dhe fundosur.

Kryepeshkopi ynë do të mbante mbi vete, peshën e rëndë të kryqit. Erdhi koha kur u përmbysh edhe thënia e profetit Isaia: **"Popu-**



Ili që ecte në errësirë, pa një dritë të madhe.

Rasti i Shqipërisë ishte unik në historinë botërore. Ishte hera e parë që një kishë gjendej pa hierarkinë e saj. Pati zëra të shumtë, që shpreheshin se Autoqefalia e Kishës Shqiptare, tashmë nuk ekzistonte, sepse nuk ekzistonte më një hierarki dhe një strukturë, e cila do ta ushtronte këtë autoqefali. Zgjidhja e këtyre çështjeve nuk ishte aq e lehtë dhe sa dukej. Siç nuk është zgjidhur ende prej dyzetë vjetësh autoqefalia e Kishës ortodokse maqedonase. Kur Kryepeshkopi Anastas iu kërkua kjo detyrë nga Patriarkata Ekumenike. Ai, vuri tri kushte për ta pranuar: Të ishte i pranuar nga komuniteti ortodoks, nga autoritetet shtetërore të Shqipërisë dhe të ruhej Autoqefalia e Kishës Ortodokse në Shqipëri. Ishte autoriteti i tij, i cili bëri të heshtin, të gjithë zërat, që ishin kundër autoqefalisë.

Kryepeshkopi Anastas Janullatos lindi në Pire, më 4 nëntor të 1929-ës. U rrit dhe u edukua nga nëna e tij, nga Preveza, tokë e vilajeteve të dikurshme shqiptare. Përfundoi shkëlqyeshëm studimet universitare dhe është Doktor i Fakultetit të Universitetit të Athinës. Ka studiuar Fetarologji, Teologji Ekumenike dhe Etnologji në Universitetin e Hamburgut dhe të Marburgut në Gjermani me bursë pasuniversitare të Fondacionit "Alexander von Humboldt". Ka studiuar Islam, Budizmin, Taoizmin, Konfucizmin dhe besime të tjera fetare.

Profesor Doktor Anastasi është Profesor i Historisë së Feve i Universitetit Kombëtar Kapadostrian të Athinës në vitet 1972-1997, dekan i Fakultetit të Teologjisë 1982-1996 dhe anëtar Korrespondent i Akademisë së Athinës 1993-2005. Që nga 1991 dhe deri më sot është Profesor Emeritus i Universitetit të Athinës dhe Anëtar Nderi i Akademisë së Athinës nga 2006.



Ejani merrni dritë, prej dritës që s'perëndon. Pashkë 1992

Gjithashtu, ai është shpallur Doktor Nderi i Teologjisë, Doktor Nderi i Filozofisë i 17 universiteteve, fakulteteve ose degëve universitare (Greqi, SHBA, Rumania, Qipro, Gjeorgji, Shqipëri, Itali). Flet anglisht, gjermanisht, frëngjisht, lexon latinisht, italisht, spanjisht dhe shqip.

Autor i dhjetëra monografive shkencore dhe mbi 240 studimeve dhe artikujve me përmbajtje teologjike fetarologjike, studime dhe artikuj që janë përkthyer në 12 gjuhë të huaja.

Duke qenë një filozof i madh i krishterimit, Ai çeli rrugën për ringjalljen e dëshmisë ortodokse në botë në ditë e sotme. Për periudhën 1981-1990 ka zhvilluar një veprimtari të gjerë hierapostolike dhe sociale. Për këtë u nderua me dekoratën, Bamirësi i madh i Patriarkanës



Duke ju lutur zotit për ngjalljen e tij



Manastiri i Shën Gjergjit, Çukë-Sarandë, 1991



Kryepiskopi në rrenojat e manastirit. Gjirokastrë 1992



Manastiri i djegur i Shën Joan Vladimirit



Gurrët e parë të ndërtimit të faltoreve të para. 1991-1992

së Aleksandrisë 2009.
KANONIZIMI SI KRYEPESHKOP I KOASH-IT

Autoqefalinë Kishës sonë, në fillim ju dha me Tomosin Patriakal në 1937.

Në janar të vitit 1991, Patriarku Ekumenik Dhimitri dhe Sinodi i Shenjtë, zgjodhën si eksark patriarkal, episkopin e Andrusës, Anastasin, që në atë kohë ishte me shërbim hieraristik në Afrikën Lindore, si kryepiskop i Kenias, Ugandës dhe Tanzanisë.

Orthodhoksët e Shqipërisë, që para fillimit të persekutimit të fesë, përbënin 21% të popullsisë, statistikë kjo, e autoriteteve italiane e vitit 1938; kërkuan që eksarku patriarkal, të qëndronte në Shqipëri dhe të merrte përsipër veprën e ringritjes së Kishës, që vazhdon të mbetet pezull. Ishte e pamundur që ajo të ringrihej nga ana e saj e brendshme, sepse nuk u gjend asnjë person klerik ose laik i arsimuar me arsimin e përshatshëm dhe i pamartuar me nënshitetë shqiptarë, për të marrë barrën e ringritjes së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. **Ky tron siç thotë edhe vetë Kryepiskopi "nuk kishte asnjë tron**



Shërbese në qiell të hapur në kishën e Apostollit Pavlit



Shërbese në qiell të hapur në Manastirin e Shën Vlashit

itë mitropolitane, shtëpi pritjeje, punishte, mensa për të varfrit, duke arrirë kështu në tërësi 450 objekte, vepra ndërtuese.

Katedralja e madhe "Ngjallja e Krishtit", e cila u shenjtërua më 1 qershor të vitit 2014 nga Tërëshenjtëria e Tij Patriarku Ekumenik Vartholomeu I dhe pothuajse nga të gjithë primatët e Kishave Orthodhokse në botë është sot preludi i ngjalljes së kishës, besimit të orthodhoksisë në Shqipëri.

VEPRA PËR SHËNDETIN

"Isha i sëmurë, - thotë Krishti, - dhe erdhët dhe më vizitua" Qendra mjekësore diagnostikuese "Ungjillëzimi" në Tiranë me 23 specialitete u gjenden njerëzve në nevojë dhe të sëmurë. Në 20 vjet të funksionimit të saj janë realizuar mbi 2.500.000 vizita dhe 6.000.000 analiza. Qendëra diagnostikuese, është jo fitimprurëse. Qendra të kujdesit shëndetësor funksionojnë edhe në vende të tjera si Korçë, Kavajë, Gjirokastrë, Lushnjë.

VEPRA ARSIMORE

Në gjurmët e Shën Kozmait të Kolkondasit, të shekullit XVIII, që hapte shkollën për arsimimin e fëmijëve, kryebariu ynë si arsimdashës dhe mbjellës i dashurisë së dijes, ndërtoi dhe themelet katër shkollave me konvikte. Ndërtoi Akademinë Teologjike "Ngjallja e Krishtit" në Shën Vlash, ku është edhe sot mësonjësorja dhe fidanishtja e përgatitjes së klerikëve të ardhshëm shqiptarë; si dhe dy shkollat të mesme kishtarë me emrin "Kryqi i nderuar" në Gjirokastrë dhe në Sukth të Durrësit. Përkudjesja dhe dashuria e veçantë për më të vegjlit bëri që 19 kopshte të fëmijëve të vegjël të ushtronte me zërat e tyre të gezuara, të bukur në Tiranë, Durrës, Kavajë, Korçë, Lushnjë, Elbasan, Çerrik, Gramsh etj. Me iniciativën e drejtëdrejtë të Kryepiskopit funksionon në Tiranë kompleksi arsimor shqiptaro-amerikan me emrin "Protagonistët", në Durrës dhe në Gjirokastrë; shkolla 9-vjeçare "Frymë

dhe shqiptarë. Kjo sepse Kryepiskopi përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të shtetasve shqiptarë të besimit orthodhoks. Presidenti i Republikës, shkëlqesia e tij z. Ilir Meta, duke vlerësuar kontributin e tij të jashtëzakonshëm si apostull i Krishtit, në të gjithë Galilenë e madhe dhe në Shqipëri, për ringjalljen e besimit të krishterë, për ringritjen e kishës në Shqipëri, rolin e tij vizionar si flamurtar i paqes dhe i dashurisë për paqen e sotme botërore, për vizionin e bashkëjetesës, harmonisë dhe tolerancës fetare, e quajti atë për kohën dhe të ardhmen; një shqiptar i denjë dhe i devotshëm, duke e pajisur atë me pasaportë shqiptare, të cilën Kryepiskopi ynë e mban dhe e përfaqëson atë me lavdi dhe krenari. Kryepiskopi Anastas është sot një nga zërat më të dëgjuar të krishterimit të kohës sonë, të globalizimit dhe një nga zërat më të fuqishëm të dialogut ndërfetar botëror.

Kryepiskopi Anastas ka dhënë mesazhe paqëje, të dialogut, të mirëkuptimit, të respektit dhe të dashurisë për të gjithë, pa dallim besimi, pozicioni kllasor dhe etnie. **"Dojini armiqët tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urre-**



Katedralja e Korçës. Madhësitë besimi



Manastiri Shën Vlashit, Akademia Teologjike, Durrës. Krenari për ardhmërin e besimit



Katedralja e Shkodrës. Vepër e re për shëjtërinë e besimit

kryepiskopal për t'u ngjitur, por ishte vetëm një stol i thyer, plot gozhdë që e kishte lënë persekutimi ateist". Për herë të parë, pas persekutimit, një përfaqësi e Kishës së Shqipërisë, e caktuar prej Këshillit të Përgjithshëm Kishitar, vizitoi Patriarkanën Ekumenike në 5-8 qershor të 1992-it dhe kërkoi zgjedhjen e Eksarkut Patriarkal si primat i kësaj Kishë.

Më 24 qershor 1992, me propozim të Patriarkut Ekumenik Vartholomeu I, me vota unanime u zgjodh kryebariu ynë Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë deri atëherë eksark Patriarkal.

Zgjedhja e Kryepiskopit, më 24 qershor 1992 sipas rregullave të orthodhoksisë ishte një akt dhe një fakt i kryer kishitar zyrtar. Ky akt u bë i ditur zyrtarisht të gjithë Kishave Orthodhokse të botës, për të përfshirë në Dipikët e tyre, pas 40 vjetësh mungese, emrin e Kishës Orthodhokse të Shqipërisë, si dhe emrin e primatit të saj, që kishte marrë tashmë përgjegjësinë për ringritjen e saj nga gërmadhat.

Shtatë vite, nga korriku i vitit 1991 si eksark patriarkal dhe nga qershori i vitit 1992, si primat, Kryepiskopi, mbajti vetë përgjegjësinë për përkudjesjen, restaurimin dhe administrimin e të gjitha Mitropolive të Shqipërisë. Me krijimin e kushteve në vitin 1998, Kryepiskopi do të formojë Sinodin e shenjtë të Kishës; prej katër anëtarësh me hierakët: Mitropoliti i Beratit Hirisë Ignati, arvanitas; Mitropoliti i Korës Hirisë Joan Pelushi; Episkopi i Apollonis Hirisë Zozma Qirjo dhe

odike një shtypshkronjë. Janë hapur shumë shkolla shqipe të të gjitha niveleve. Kryepiskopi u ka ofruar bursa mijëra të rinjve për të vazhduar studimet e larta në fakultetet të ndryshme.

460 enori orthodhokse u riorganizuan. Me kujdesin e Kryepiskopit u arsimua dhe u hirtonis një brez i ri klerikësh nënshetas shqiptarë, në Akademinë Teologjike "Ngjallja e Krishtit" - Shën Vlash Durrës dhe në shkollat e larta jashtë shtetit. Sot, më shumë se 150 klerikë me arsim të lartë shërbejnë si klerikë në të gjithë vendin, duke përcjellë mesazhin ungjillor **"Dua je Zotin dhe dua je të afërmin si veten tënde"** dhe në meshën e Shën Joan Gojfarit lutën: **"Për Republikën e Shqipërisë, qeverinë, ushtrinë dhe gjithë popullin shqiptar, le t'i lutem Zotit".**

50 qendra rinore funksionojnë nëpër qytete dhe fshatra. Kryepiskopi Anastas vlerëson shumë dhe preokupohet veçanërisht për rininë, që sipas vizionit të tij atëror: **"Rinia nuk është vetëm e ardhmja, por edhe e tashmja".**

Duke punuar për të ndërtuar vreshtin e grigjës së tij, u ngritën nga themelet 150 kisha të reja, të mëdha e të vogla; u restauruan 60 kisha, manastire, monumente kulture, u riparuan 160 kisha të tjera. Për funksionimin sa më mirë të infrastrukturës së kishës janë ngritur, blerë, rikonstruktuar më shumë se 70 godina për kopshte, shkolla, qendra rinore, qendra shëndetësore, sel-

Dashurie". Prej vitit 2013, shkolla e mesme "Platoni", në Korçë, në Mesopotam në Sarandë shkolla e mesme teknike "Apostull Pavli".

Në mjediset e manastirit të Shën Vlashit, nën kujdesin e Kryepiskopit funksionon Shtëpia e Fëmijëve "Shpresa". Në tetor të vitit 2012 u hap në qendrën "Fabor" shkolla e parë e Muzikës Bizantine me konvikte. Në Tiranë dhe Gjirokastrë funksionon Instituti i Formimit Profesional "Frymë Dashurie", në Tiranë funksionon shkolla e lartë "Logos".

Për të ruajtur dhe konsoliduar vlerat e trashëgimisë kulturore, me pasionin e tij është ngritur një institucion i veçantë, studio për pikturim dhe restaurimin e ikonave. Deri sot janë restauruar rreth 600 ikona. U përgatit një brez i artistësh, që po rigjallërojnë traditën tonë të pasur ikonografike të autorëve shqiptarë si Onufri, Kostandin Sphataraku etj., për të cilat janë shpenzuar deri tani disa milionë euro.

Stacioni radiofonik "Ngjallja" me frekuencë 88.5 Mhz në FM, nga viti 1998, transmeton 24 orë programe të ndryshme.

Kisha sot merr pjesë në të gjitha veprimtaritë e Kishave Orthodhokse në mbarë botën. Ajo është anëtare e Konferencës Europiane të Kishave, anëtare e Këshillit Botëror të Kishave. Pjesëmarrja e Kryepiskopit Anastas, si primat i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, në këto evente ndërkombëtare është një lavdi ju vetëm për Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, por për të gjithë vendin

inë dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndajnë". Vetëm mbi këtë themel hyjnor, - thotë kryebariu ynë, mund të ndërtohet një shoqëri e shëndoshë dhe njerëzore. Një kontribut tjetër i madh i Kryepiskopit Anastas është ndikimi i tij si diplomat i dashurisë, së të vërtetës dhe paqes për uljen e tensioneve midis shteteve, grupeve etnike dhe komuniteteve fetare. Le të kujtojmë thënieën e tij lapidare dhe plot kurajë për luftëtarë dhe konfliktet e dhunshme: **"Askush të mos xuxojë të përdorë vajin e kandilit të Kishës për të ndezur zjarrin e urrejtjes fetare".** Në vitin 2000 me propozimin e 33 akademikëve nga Akademia e Athinës dhe e shumë personaliteteve të Shqipërisë ka qenë kandidat për çmimin Nobel për paqen.

Nuk është rastësi që Kryepiskopi ynë mban emrin Anastas, që do të thotë "Ngjallje" - Ngjallje e Krishtit në Shqipëri, ngjallje e besimit, ngjallje e orthodhoksisë, ngjallje e shqiptarëve.

Dje në "Deutsche Welle"

Financimi partiak në Shqipëri - xhungla gati e padepërtueshme

Nga Lindita Arapi

(vijon nga faqja 1)

... i dëshiruar në politikën shqiptare. KQZ mbetet një tigër pa dhëmbë.

Lajmi i publikuar nga revista amerikane "Mother Jones" ishte një bombë politike në Shqipëri. Sipas kësaj reviste, në favor të një fushate lobimi për Partinë Demokratike e të kryer nga Nick Muzin Company janë paguar qindra mijëra dollarë nga një firmë hije Biniatta Trade. Partia Demokratike e kundërshtoi ashpër artikullin. Ajo pranon kontratën me Nick Muzin, por thekson se pagesa e saj ka qenë vetëm 25.000 dollarë në muaj.

EMBTUR PEZULL

Demokratët akuzojnë kundërshtarin politik për fushatë shpifjeje kundër PD-së. Por Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste, Taulant Balla nuk e pranon këtë. Afera e parave prek edhe sigurinë kombëtare, thotë ai për Deutsche Wellen. "Kjo çështje është një çështje që prek sigurinë kombëtare të Shqipërisë, po të kemi parasysh edhe një prirje të kahershme të Rusisë për të shtirë ndikimin e saj. Ndoshta Shqipëria dukej i vetmi vend imun deri më tani."

Një aferë me lëndë shpërthyes, po të kujtosim se tradicionalisht shqiptarët nuk e kanë parë si ndonjë vend mik të veçantë Rusinë, përjashtojnë kohën e miqësisë me sovjetikët në kohën e diktaturës. Po fusin hundët rusët edhe në Shqipëri? Politologu Afrim Krasniqi thekson se në Shqipëri "pranohet gjerësisht se asnjë parti politike shqiptare nuk përfaqëson ndikim rus në politikë". Efekti i kësaj afere është më shumë politik, thotë ai. Për momentin çështja e burimeve financiare për fushatën lobuese të PD-së ka mbetur pezull, por edhe e pazbardhur përfundimisht.

SHUMA LUKSOZE QË TEJKALOJNË BUXHETIN E SHTETIT

Ndërkohë që furtuna e ngritur për burime të pasqaruara financimesh duhet të ishte kthyer në një uragan të vërtetë derisa opinioni publik shqiptar të dijë se si e nga kush financohen partitë politike, të cilave votuesi u jep votën. Por heshtja flet nganjëherë më shumë. Dihet se trans-



parenca e financimit të partive politike është një problematikë e vjetër në Shqipëri, një problematikë realisht gjithmonë e dështuar.

Prej vitesh partitë politike japin shuma luksoze për të lobuar jashtë apo për të organizuar fushata e mitingje që në një vend të varfër si Shqipëria tingëllojnë më shumë si tallje për njerëzit në nevojë. Rreth 2 milionë euro dhanë tri partitë kryesore politike për lobim në SHBA në vitet e

fundit, sipas Institutit të Studimeve Politike në Shqipëri. Ndërkohë buxheti i shtetit shqiptar jep mesatarisht (sipas vitit zgjedhor) rreth 1,6 milionë dollarë (rreth 1,6 milionë euro) për të gjitha partitë politike në Shqipëri. Nga vijnë kaq shumë para?

Drejtori i Institutit për Studime Politike, Afrim Krasniqi, që e vëzhgon prej vitesh këtë problem, konstaton një sistem klientelist dhe abuzues. "Formalisht partitë i deklarojnë finan-

cimet e shpenzimet, por pa dhënë detaje mbi pagesat. Shifrat e deklarimit jashtë sistemit (pa transparencë e deklarim të rregullt në KQZ) janë shumëfish më të mëdha."

MUNGESA E TRANSPARENCËS SË FINANCIMIT - PROBLEMI RAJONAL

Një problem që nuk prek vetëm Shqipërinë. Johanna Deimel, eksperte në Shokatën e Europës Juglindore thekson për DW se është shumë e vështirë t'ia gesh-

burimin fluksit të parave që hyjnë tek partitë e vendeve të Ballkanit. "Problemi i financimeve të fshehura apo ilegale të partive dhe mungesa e transparencës bën pjesë ndër problemet kryesore në rajon. Paratë rrjedhin ose drejt e tek politikanët apo partitë, ose jo drejtpërdrejt përmes kanaleve të tjera, si financimi i mediave përkrahëse apo firmave të rëndësishme e besnike."

KQZ-TIGËR PA DHËMBË

Institucioni më i rëndësishëm i kontrollit për partitë politike në Shqipëri është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Por ai i ngjason më shumë një tigri pa dhëmbë. E si mund të jetë ndryshe, kur anëtarët e tij përcaktohen nga partitë proporcionalist, e më pas ky komision emëron auditët, që do të kontrollojnë partitë. E kush e kafshon dorën që e ushqen?

Partitë bëjnë sikur kontrollojnë veten, por realisht krijohet një qark i mbyllur. Kushte më të favorshme për

të vazhduar lojën e vjetër kukafshehthi të financimeve zor se gjen. Politologu Afrim Krasniqi, i cili ka ndjekur edhe raste kur deputetë shqiptarë flisnin hapur për qindra mijëra euro të paguara për partitë, pa asnjë pasojë konkrete, është mjaft kritik. "Arsyeja kryesore e kësaj gjendjeje është konsensusi politik për të evituar transparencën financiare për shkak të shpenzimeve të larta që kanë fushatat elektorale dhe tregut informal që funksionon në këto fushata."

Problemi i pranoi edhe kryetari i KQZ-së, Klement Zguri para Komisionit Parlamentar të Ligjeve para disa ditësh. "Partitë politike në njëfarë mënyre tentojnë për të fshehur, ndërkohë që institucioni do të kërkojë transparencë...do të kemi punë."

"BAZA LIGJORE ËSHTË GJYSMAKE"

Kush kërkon transparencë duhet t'i drejtohet ligjit, mund të thotë dikush. Por partive shqiptare duket sikur u vjen në ndihmë edhe ligji. "Baza ligjore është gjysmake, e bazuar në verifikimin formal të deklarimit e pa forcë konkrete verifikimi në burimin e financimit, legjitimitetin e financimit dhe konfliktet e interesit", kritikon Afrim Krasniqi.

Edhe OSBE pranon problemet me legjislacionin në një prononim për Deutsche Wellen, ku theksohet se në legjislacion ka ende boshllëqe që duhen plotësuar. "Ligji nuk garanton transparencë të mjaftueshme për raportimin e financimit të fushatave, pasi nuk imponon detyrime raportimi para ditës së zgjedhjeve." OSBE kërkon që "KQZ-ja, ekspertët financiarë dhe votuesit duhet të kenë akses në informacion të plotë rreth financimit. Financimet e partive politike duhet të dalin në dritë, që qytetarët shqiptarë të informohen se kush financon dhe kush influencën në skenën politike të vendit të tyre."

Kërkesë e drejtë, por që në Shqipëri tingëllojnë si një ëndërr e largët, aq larg sa ç'duket për momentin edhe anëtarësimi në BE. Sepse pa hyrë drita në xhunglën e financimeve të partive shqiptare, që publiku të ketë siguri se aty nuk kanë dorë grupet kriminale, BE do ta mbajë Shqipërinë në prag, por nuk do ta fusë brenda.

Opinioni *i* Ditës

Pse dhuna është e vetmja rrugë

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... kundër policisë, rrugëve të përbashkëta dhe pronave të oligarkëve, me të cilët po qeveris kryeministri.

Dua të jem i qartë që në fillim. Sipas meje kjo është thjeshtë vetëmbrojtje. Dhuna është tjetër gjë. Dhunë është ajo që po ushtron pushteti. Dhunë është që pronat publike, trojet pa pronarë të ndërtimit, inceneratorët për djegien e plehrave, pallatet tek Teatri Kombëtar dhe kulla tek stadiumi, u falen oligarkëve që ndajnë paratë me pushtetin. Dhunë është kur për koncesionin e Check Up-it shtohen pa nevojë paratë, megjithëse në spitale nuk ka fonde për të sjellë mjekimin e kimioterapisë. Dhunë është kur një anonim i panjohur, mik i ministrit, fiton koncesionin e pajisjeve mjekësore, që sot kirurgëve u thyen në duar. Dhunë është kur votat rëmbehen me premtimin zero ndërtim dhe pastaj shpik qindra mashtrime vetëm për të mbushur xhepat me paratë e kullaxhinjve.

Pikërisht ndaj kësaj dhune, që dirigjohet nga tepsia e mbetur në një dorë të vetme, duhet reaguar.

Ditët e fundit ne jemi ndeshur me dy lloj reagimesh.

I pari ishte ai i aktorëve të Teatrit Kombëtar. Ata u përballën me urdhrin për t'i nxjerrë për leckash nga godina, sepse aty duhej të ngriheshin gjashtë kulla mbi pronë publike. Me patosin, edukatën, naivitetin dhe lirizmin që i karakterizon, këta artistë nisën të protestojnë. Por, as ditëmbet epike të Bujar Asqerit, as racionaliteti serioz i Robert Ndrelikës, nuk patën asnjë efekt. Pa pyetur për zërin e tyre, madje duke i ndërprerë edhe publikisht fjalën Ndrelikës, Rama i mblodhi në kryeministri aktorët për t'ua përplasur në fytyrë mandatën: "Gërmadha juaj do të shembet". Natyrisht, si gjithnjë, me një projekt të miraturat vetëm nga ai dhe me një firmë ndërtesë që do t'i dhurohet tokë publike pa garë dhe pa tender.

Ashtu si me aktorët, Edi Rama mendoi të sillte edhe me kuksianët. Ai organizoi një tender banditesk, ku u zhduk sa hap e mbyll



sytë fituesi i vendit të parë (më pas nën rrogoz u përdor një argument erdoganesk, se fituesit ishin gjenistë). Më pas ai nxitoi të vinte traun që në xhepat e koncesionarit të futeshin me urgjencë eurot e trafikut që vjen bashkë me stinën e verës. Dhe aq arrogant e mospërfillës ishte ky tra, sa që privati të mos harxhonte para për ndërtimin e shumë pikave, u caktua një takse e njëjtë si për atë që bënte rrugën Tiranë-Prishtinë, si për atë që duhet të bënte vetëm pak kilometra për të shpënë fëmijën në spital.

Kështu ishte kjo histori arrogance pushteti që nuk përfilli askënd tjetër përpos interesave të Ramës dhe koncesionarit. Kundër

kësaj u ngritën kuksianët. Ata reaguan radikalisht, thyen traun, krisën xhamat, shkruamant kompjuterët dhe e rrëzuan barrierën oligarkike, që kërkonte t'u merrte frymën.

Me sa duket kishin të drejtë.

Po të gjykosh nga justifikimet e sotme të kryeministrit del se po. Ai kërkoi ndjesë disa herë. Ai tha se qeveria kishte gabuar që nuk kishte bërë punën e duhur sqaruese. Ai filloi të flasë për klauzola kontrate që lehtësojnë banorët dhe ideja se kuksianët do të diskriminohen pozitivisht për taksen e rrugës, po gjen gjithnjë e më shumë mbështetës edhe brenda mazhorancës (madje bashkë me të

si bonus u dha dhe hapja e aeroportit që mbetet i kycur prej vitesh).

Tani pyetja që shtrohet është: si mund të zbrapset Edi Rama, me fjalimet poetike të Bujar Asqerit, apo me shkopat dhe gurët e "vandalëve" kuksianë?

Vetëm me dy shembujt e fundit, Rama na e ka dhënë përgjigjen e kësaj dileme. Ai dhe grupi i oligarkëve më të cilët ndan paratë, nuk pyesin për kritikë racionale dhe zërat e arsyeshem. Ata tërhiqen vetëm para asaj që kanë filluar ta etiketojnë si dhunë, megjithëse nuk është gjë tjetër veçse vetëmbrojtje e thjeshtë ndaj dhunës sistematike që po ushtrohet prej pesë vitesh. ©Lapsi.al

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALLONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

HOROSKOPI

DASHI

Jeni përballë një zgjedhjeje të rëndësishme, qëndroni zgjedhjeve të bëra më parë dhe mos hiqni dorë nga autonomia juaj. Mos i lejoni një familjari t'ju pengojë. Do t'ia dilni të angazhoni në nisimat tuaja, duke prekur pikat e dhura emocionale.

DEMI

Hëna nuk shkon mirë me Plutonin në djellin tuaj dhe atmosferën që jetoni me atë që ju ka hyrë në zemër. Pakenaësia pirret të mbizotërojë. Mos e vini në dyshim atë që ndjeni për partnerin që në zënat e para që keni me të.

BINJAKET

Keni nevojë të kaloni çaste të qeta. Largoni me takt persona që nuk janë shumë pozitive, të cilët ju marrin nëpër këmbë dhe buzëqeshin jetës. Hëna bën që të provoni të zgjidhni një problem midis miqve, por nuk do ta keni të thjeshtë.

GAFORJA

Marsi dhe Venusi ju mbështesin. Dashuria do të vazhdojë të ketë një rol shumë të rëndësishëm në jetën dhe mendimet tuaja. Do të përjetoni edhe anë e ëmbëla. Një vizitë e juaja, edhe pse e shkurtër, do të gëzojë një familjar apo një të afërm. Do të ndiheni të kënaqur.

LUANI

Me Uranin kundra, nuk është rasti për të bërë beteja kundër mullinjve të erës, prandaj mos e çoni ndër mend se mund të ndryshoni botën! Si zakonisht, mbi të gjitha për çështje pune, reagoni duke u mbështetur mbi vendosmërinë dhe saktësinë.

VIRGJERESHA

Me Uranin, Saturnin dhe Plutonin bashkëpunorë, perspektivat sentimentale janë të mira. Mund të nisni një histori pasioni, e cila mund të kthehet në një lidhje të qëndrueshme. Ndoshta në dashuri nuk jeni ende gati për të ndërmarrë hapin madhor, por me siguri drejt asaj rruge jeni.

PESHORJA

Në familje do të keni disa kundërshtime të shkaktuara nga këndvështrimet e ndryshme. Mos u mërzisni, larmishmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për t'u ngritur. Falënderoni koteqet që ju rinin pranë duke ju dhënë ide dhe mundësi të mira.

AKREPI

Sot jvet nuk janë shumë të shkëlqyeshme. Do të shqetësoheni për çështje profesionale, të cilat do të dalin se nuk janë problematike! Në punë mos bini shumë në sy, rini të qetë dhe shfaqini aftësitë tuaja në momentin e duhur.

SHIGJETARI

Nën mbikëqyrjen e Plutonit, ditën e sotme do të vihet në pah ana më kokëfortë e karakterit tuaj. Mbase mund të rikthehen zënka të vjetra familjare, nxitimi mund të bëjë që të gaboni. Prandaj përpara se të veproni, mendojeni mirë atë që do të bëni.

BRICJAPI

Për meritë të pozicionimit të Saturnit në lidhje me Hënën dhe Diellin, do të përballeni me shpirtin e përshtatjes një ndryshim të papritur programi. Me një shtytje të mirë do të jetësoni projektet tuaja, duke tejkaluar pengesat.

UJORI

Përpiquni të mos të keni besim të pakufishëm në burimet tuaja dhe përpiquni të jeni më objektivë, nëse nuk doni që të përballeni me zhgënjime. Kujdesuni për shëndetin! Bëni veprimtari fizike dhe shëtitje në natyrë.

PESHQIT

Keni arsytet më të mira për të ndihmuar një familjar që të tejkalojë vështirësitë dhe pasiguritë. Në këmbim do të merrni shumë mirënjohje të singërta. Me Jupiterin në shenjë, do ta keni rrugën e hapur për të pasur veprimtari kulturore.



Mesfushori merr çmimin "Lojtari i muajit"

Mala: Shtutgarti? Mendoj vetëm për Partizanin

Mesfushori kosovar i Partizanit, Esat Mala, është përzgjedhur nga shoqata "Sporti na bashkon" lojtari më i mirë i muajit mars për Superiorene. Pasi ka marrë këtë çmim simbolik, futbollisti kosovar u është përgjigjur pyetjeve të gazetareve në konferencën për shtyp në ambientet e

klubit të kuq. Mes të tjerash Mala thekson se mendon më shumë për të tashmen se për të ardhmen, ndërkohë që ka besim të madh për ta mbyllur kampionatin në vend të dytë: "Prej kur kam ardhur te Partizani, vetëm jam rritur shumë profesionalisht. Më kanë ndihmuar shumë stafi teknik dhe grupi i

lojtarëve. Ndihem shumë mirë dhe jemi në një etapë të re, në formë shumë të mirë. Personalisht, jam shumë i kënaqur, sepse nuk është e lehtë të jesh titullar te Partizani. Me besim dhe punë mund të arrihet gjithçka. Do të vazhdoj t'i vlerësoj minutat që më jep trajneri për të bërë më mirë në time.

Shtutgarti? Nuk është se di ndonjë gjë. Mund të them se jam i fokusuar vetëm te Partizani. Çfarëdo që të ndodhë, do të vendosin drejtuesit e këtij klubi, bashkë me mua. Po shoh të tashmen në këtë moment dhe jo të ardhmen. Mendoj se jemi kandidatë të fortë për vendin e dytë në kampionat. Objektivi ynë është Europa, që me shumë mundësi do ta arrijmë me vendin e dytë"-tha ndër të tjera talenti i Partizanit.

Theodor Maslavica është zgjedhur në krye të FSHP-së, theu në garë zv/presidentin në fuqi

Jeton Selimi

**Peshëngritja me president të ri!
Maslavica: Tolerancë zero dopingut**

Mposhti rivalin e tij, Ilir Tonuzi, 19-2

Theodor Maslavica është presidenti i ri i peshëngritjes! Maslavica ka mposhtur në garë kandidatin tjetër dhe zv/presidentin në fuqi, Ilir Topuzin, me rezultatin e thellë 19-2, ndërsa në sallë nuk ka munguar entuziazmi i të pranishmëve. Në një kohë kur peshëngritja shqiptare ka përjetuar skandale të njëpasnjëshme, Maslavica premtom një federatë të pastër dhe falënderon të gjithë ata që e kanë mbështetur në këtë betejë. "Jam shumë i lumtur për këtë arritje. Dua të falënderoj të gjithë aktorët e kësaj gare. Dua të falënderoj dhe përfaqësuesit e Federatës Europiane të Peshëngritjes dhe presidentin e KOKSH-it që nderuan këtë asamble me prezencën e tyre. Unë premtom një federatë të pastër dhe do të punoj fort për këtë,"-u shpreh presidenti i sapozgjedhur përpara mediave. Natyrisht që Theodor Maslavica nuk mund t'i shmangej pyetjeve mbi dopingun, ndërsa premtom tolerancë zero ndaj fenomenit. "Është gjëja kryesore mbi të cilën do të punojmë. Do të ngremë strukturat tona të antidopingut dhe do ta luftojmë fort këtë fenomen. Dopingu do të ketë tolerancë zero nga tani e në vazhdim," u shpreh Maslavica. Kandidati humbës në këtë garë, zv/presidenti Ilir Topuzi,



uron rivalin e tij dhe deklaroi se përkundër aludimeve, zgjedhjet kanë qenë demokratike dhe çdo gjë ka shkuar në rrugën e duhur. Ndërsa mori vetëm dy vota, Topuzi u shpreh i kënaqur për mbarëvajtjen e asamblesë. "Humbje e thellë? Kështu menduan dhe votuan në asamble. Unë jam i kënaqur që gjithçka shkoi mirë, ndonëse ju në media

keni aludur se sot (dje) do të bëhej nami. Siç mund ta shikoni edhe vetë, këto zgjedhje ishin demokratike. Dua të uroj kandidatin fitues", - deklaroi fillimisht Topuzi, ndërsa më pas zv/presidenti në fuqi i Federatës Shqiptare të Peshëngritjes shtoi se do të japë mbështetje për presidentin e ri, Theodor Maslavicën. "Natyrisht që do ta mbështesim. Do të dëgjojmë me vëmendje platformën e tij dhe ato që ai ka ndërmend të bëjë në peshëngritje. Pastaj nëse do të na kërkojë ndihmë, do të jemi aty për ta ndihmuar, përfundoi Topuzi. Punimet e asamblesë zgjedhore u ndoqën nga pranë nga përfaqësues të Federatës Europiane të Shtangës si dhe nga ana e presidentit të KOKSH-it Viron Bezhani.

KËRCËNOHEN NIKI E RICOLI

Skandal në Itali, zarf me plumb për krerët e gjykimin

Problemet me gjykimin janë kudo, jo vetëm në Shqipëri. Edhe në Itali gjykimi, sidomos pas futjes së teknologjisë, është bërë një çështje shumë e diskutueshme. Drejtuesit e Shoqatës Italiane të Arbitrave ndihet të kërcënuar. Presidenti i kësaj shoqate, Marcello Niki, ka bërë të ditur se ai, nënkryetari i shoqatës dhe Ricoli, disenjatori i arbitrave, kanë marrë zarf me plumba brenda. Për këtë që ka ndodhur janë vënë në dijeni institucionet përkatëse, edhe Ministria e Punëve të Brendshme. Gjithçka është raportuar nga presidenti Niki gjatë një konference shtypi të mbajtur në Romë: "Po ndodhin gjëra ekstreme dhe askush nuk thotë asgjë. Tani ka arritur kulmi", - ka pohuar gjatë konferencës drejtuesit i sektorit të gjykimin në Itali.

KONTRATË E MAJME

Talenti 9-vjeçar firmos me "Puma"-n

Firmat e njohura paguajnë shuma marramendëse për t'u bërë sponsor të futbollistëve më të mirë, ndërsa disa prej tyre nxitojnë ta bëjnë një gjë të tillë me talente në moshë të vogël. Këtë gjë ka bërë edhe një firmë e veshjeve sportive në Brazil, e cila ka firmosur një marrëveshje sponsorizimi me një 9-vjeçar. Djaloshi quhet David Nogueira Carmo dhe është pjesë e ekipit të Santosit. Ai ka arritur të firmosë një kontratë 6-vjeçare me firmën e veshjeve sportive, "Puma", e cila shpreson se talenti do të bëhet një lojtar i madh. 9-vjeçari bëhet futbollisti më i ri që arrin një marrëveshje sponsorizimi. Një kontratë të tillë e ka marrë edhe Neymar në moshën 12-vjeçare. Djaloshi ka statistika shumë premtuese, ku ka shënuar 56 gola në 43 ndeshje dhe në Brazil presin shumë nga ai në të ardhmen.



REAL MADRIDI




Plani për të mbajtur Ronaldo, Perez e Mendes punojnë "nën rrogog"

Forma e jashtëzakonshme e Cristiano Ronaldo ka efekt të mrekullueshëm. Portugezi jo vetëm po e çon skuadrën e Zidane në çatinë e Europës, por mbi të gjitha po largon edhe dyshimet për largimin e mundshëm nga Reali. Pasi Ronaldo i tha "Jo" Kinës, për të u hodhën në sulm PSG dhe Manchester Junajtid, por, në fakt, heshtja e agjentit të tij, Jorge Mendes, duket se e ka një shpjegim. Ai është duke punuar për rinovimin e kontratës, ndërkohë që ka dhe një hetim në Spanjë për evazion fiskal. Lojtari duhet të zgjidhë këtë problem ligjor, pasi është edhe rreziku i burgut. Por Reali mund t'ia gjejë zgjidhjen, duke e ndihmuar në këtë aspekt. Askush nuk e

pranon hapur, por rruga e ndjekur nga avokatët e Ronaldos ka miratimin e Realit. Viti 2018 nisi me bindjen se Ronaldo do të largohej nga Madridi, por gjërat kanë ndryshuar. Te Reali askush nuk konfirmon dritën jeshile për rinovimin e kontratës me portugezin. Mendes nuk është në Spanjë këto ditë, por ai do të ndjekë ndeshjen e kthimit me Juventusin nga afër dhe deri atëherë do të ketë të reja. Ronaldo ka kontratë deri në vitin 2021 dhe Mendes nuk nxitohej. Florentino Perez është i vetëdijshëm për situatën dhe po bën gjithçka për të bindur Ronaldon, duke i rritur rrogën. Ai dhe Mendes duket se po punojnë në fshetësi që portugezi të mos lëvizë nga Madridi.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Bëjnë arte me re.
2. Krijoi Arsene Lupin (inic).
3. Janë forma.
10. Në hyrje të plazhit.
11. Kapen të parat.
13. Janë ufo.
14. Mbahen nga ata që i thyejnë.
18. Inicialet e Mascagnit.
19. Në krye të trupave.
20. Eshhtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
22. Pak hemorragji.
23. U shkrua nga Jack London.
25. Institucione Ndërkombëtare Europiane.
26. Scarlet e Bashkë me erën.
27. Janë tituj në ekran.
29. Eric aktor.
31. Kështu e ka syrin vigjilenti
32. Janë nofka.
35. Një provë... intelligence.
37. Mund të jenë me sahat.

VERTIKAL

1. Malet pa kufij.
2. Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
4. Inicialet e Altman.
5. Një sportist që arrin majat
6. Courier ish-kampion i tenisit.
7. Fillojnë testin.
8. Mund të jetë parabolike.
9. Bie me ballë.
10. Camera, ish-kampion i ringut.
11. Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
12. I kanë rrenjë të tokë.
15. Eshhtë pushkë.
16. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
17. Takim Brezash Durrës.
21. Ishte lumi i Elizit
22. Eshhtë kardinal.
24. Mbyllin një krah.
28. Artikull anglez.
30. Mbyllin fushatat.
31. Partia pa ara.
32. Zola që shkroi Nana
33. Nganjëherë duhen vënë mbi i.
34. Një fjalë kastile
36. Inicialet e Mann shkrimtar.
39. Maiden që këndojnë.
41. Ai i shtatë është kinemaja.
43. Fillojnë arsyetimin.
45. Eshhtë nënë e Tironës.
46. Eshhtë shahu i fundit.
48. Inicialet e Klee piktor.
49. Dy asa.
50. Mbarojnë fare.

Fjalëkryqi (2)



HORIZONTAL

1. Patricia këngëtare.
5. I vocërr ai i Migjenit
9. Hari spiune.
12. Qyteti i Robespierre.
14. Phineas i famshëm i cirkut.
16. Pak latinisht.
17. Incilet e Banderas.
19. Janë tek në rrota.
20. Pak efikasitet.
22. Eshhtë shkolla fillore.
24. Arrihet duke aderuar
27. Pak iniciativë.
28. Një... art i Don Judd.
29. U kompozua nga Rachmaninov.
31. Diku në qendër.
32. Një është për të lidhur.
33. Jepet për hartim.
35. Sergej, poet i famshëm rus.
37. Veriu pa kufij.

VERTIKAL

1. Eshhtë edhe ai i sheqerit.
2. Eshhtë lloj papagalli.
3. Një Pop i Andy Warhol.
4. Sapo fillojnë.
6. Qendër në Kubë.
7. Eshhtë pluhuri si Dash.
8. Eshhtë e hollë dhe therëse.
9. Fillojnë muzikën.
10. Një kontinent i ri.
11. Eshhtë për medaljen e parë.
13. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj per-sëve.
15. Provinca e boerëve.
18. Eshhtë qyteti i njëmbjeshë dritareve.
21. Eshhtë dukuria.
22. Eshhtë hidrokarbur.
23. Griffith aktore.
25. Qe perëndesha e fitores.
26. Mbeten në fund.
30. Tregon çmimin.
34. Këndohet në opera.
36. Para Fe në New Mexico.
37. Eshhtë princ arab.
38. Tony që këndon Quando, quando, quando.
40. Bën mëza.
45. Pak tolerante.
47. Modem pa zë.
48. Pak marramendëse.
50. Mbyllin një dyqan.
52. Fillojnë teorikisht.

Gjeni ndryshimin

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

3			9			4		
		1	6			9		8
			7					2
			4				2	5
		9				3		
1	3					8		
4					5			
5		3			6	4		
	8			1				7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	6	9	1	3	5	2	8	7
1	7	5	2	9	8	6	4	3
8	3	2	7	6	4	1	9	5
9	5	8	4	1	3	7	2	6
3	4	7	6	8	2	5	1	9
6	2	1	5	7	9	8	3	4
7	8	4	9	5	1	3	6	2
2	1	6	3	4	7	9	5	8
5	9	3	8	2	6	4	7	1

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik

Argëtim filozofik

- Të jesh me karakter do të thotë të jesh i drejtë edhe kur s'të sheh njeri.
- Kurrë s'e bëj gabimin e të debatuarit me njerëz, për opinionet e të cilëve nuk kam respekt. (Edward Gibbon)
- Nuk është e bukur ajo që është e bukur, por e bukur është ajo që ju pëlqen. Italiane
- Fillimi i mirë - garanci e mbarimit të mirë. Fishart

KRIPTOSKEME

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19
6	4	1	3		11			3	4	18	14
13		4		3	2	4	3	2	4	5	3
	7	2	9	5	4	6	5	4	5	3	18
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3		14
19			3	2	16	1	4		2	3	2
	7	4	6	14	5	2			1	11	5
5	11	1		6	11	14		4	2	18	11
3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2
18	8		4		5	7	6	14	6	3	5
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	3
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	6

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	U	L	M	S	M	M	A	S	A	T
A	R	B	E	E	M	L	I	M	A	
K	D	E	L	E	G	A	T	E	T	L
M	I	T	O	M	A	N	E	T	D	E
K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	T
O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	F
N	I	E	N	O		G	A			
P	S	N	N	I	M	A	L	L	I	
A	M	I	A	N	T	K	O	S	E	
N	O	T	E	K	I	P	O	R	E	
I	T	N	E	T	I	L	E	N	I	E
K	R	I	M	I	S	I	R	T	A	K

Thënie të mençura

- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë kur sulmohen në pikat e dobëta.
- Asgjë nuk është më e shtrenjtë, se sa ajo që blihet me lutje..!
- Nëse asnjë s'të ka zili, dije se ti je njeri i dështuar. Pema me kokrra synohet, tjetra harrohet...
- Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë. (Albert Anjshajn)
- Është më mirë t'i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni. (Mark Tueni)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!